



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 44

Tiranë – E enjte, 26 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 129, datë 20.2.2026	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 3363
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 165, datë 18.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 3363
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 168, datë 19.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës..... 3365
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 14.1.2026	Me objekt konstatimin si antikushtetues të ekstradimit të Igor Kokunov në Federatën Ruse. Shfuqizimin e vendimeve nr. 578, datë 14.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; nr. 591 (30- 2024-2077), datë 20.3.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-1533(222), datë 24.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut të aktit të miratimit nr./21 prot./A.H., datë 14.10.2024, të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e Igor Kokunov. Konstatimin si antikushtetues të të gjitha veprimeve të kryera nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pas dhënies së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, datë 30.10.2024, ora 17:15, për pezullimin e ekstradimit. Konstatimin si antikushtetues të veprimeve të administratës së Gjykatës Kushtetuese të pasqyruara në: 1. Shkresën nr. akti I-8, datë 10.10.2024, të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit. 2. Shkresën nr. akti I-8, datë 17.10.2024, të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit..... 3366

Urdhër i kryetares së Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 22.1.2026	Për delegim kompetencash.....	3398
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 149/4, datë 23.2.2026	Për një ndryshim në VKM-në nr. 608, datë 23.10.2025, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugëve ‘Kujtim Laro’ dhe ‘Kongresi i Manastirit’”.....	3399



URDHËR

Nr. 129, datë 20.2.2026

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë”, i ndryshuar; të vendimit nr. 598, datë 15.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 969, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij”, si dhe të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë, dhe me qëllim garantimin e funksionimit efektiv, përfaqësimit të balancuar dhe rritjes së rolit të të rinjve në vendimmarrje,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të bashkëkryetari, z. Dashnor Veizaj, të zgjedhur nga të rinjtë në Këshillin Kombëtar të Rinisë, për ushtrimin e këtyre kompetencave:

a) thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve, në mungesën time, të Këshillit Kombëtar të Rinisë, sipas rendit të ditës të dakordësuar;

b) koordinimin e grupeve të punës dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve të miratuara;

c) ushtrimin e çdo kompetence tjetër funksionale që lidhet me mbarëvajtjen e punës së Këshillit Kombëtar të Rinisë, përveç atyre që, sipas ligjit, përbëjnë kompetencë ekskluzive të ministrit.

2. Ky delegim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri në nxjerrjen e një urdhri të dytë.

3. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Mbështetjes për Rininë, Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Sektori i Arkiv-Protokollit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

URDHËR

Nr. 165, datë 18.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70°C në 3.6 sekonda;

iii. 74°C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:



Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Thuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Biezuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęzewo*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*

52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuly	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminiek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skierniewice	Lipec Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyzna*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*

Shënime: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrotjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrotjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrotjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh,



shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 132, datë 9.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 168, datë 19.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Drenthe	Aa en Hunze*
2.	Gelderland	Barneveld*
3.	Gelderland	Kesteren*
4.	Gelderland	Hummelo en Keppel*
5.	Flevoland	Noordoostpolder*
6.	Friesland	Achtkarspelen*
7.	Gelderland	Ede*
8.	Flevoland	Dronten*
9.	Noord-Holland	Beverwijk*
10.	Groningen	Delfzijl*
11.	Zuid-Holland	Dordrecht*
12.	Zeeland	Hulst*
13.	Limburg	Meerlo-Wanssum*
14.	Limburg	Helden*
15.	Overijssel	Wierden*
16.	Flevoland	Zeewolde*
17.	Gelderland	Nijkerk*
18.	Gelderland	Harderwijk*
19.	Drenthe	Coevorden*
20.	Gelderland	Ermelo*
21.	Noord-Brabant	Woudrichem*
22.	Limburg	Venray*
23.	Noord-Brabant	Deurne*
24.	Noord-Brabant	Oisterwijk*
25.	Zuid-Holland	Maasland*
26.	Gelderland	Buren*
27.	Overijssel	Almelo*
28.	Groningen	Stadskanaal*
29.	Friesland	Dongeradeel*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.



6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 157, datë 17.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 2, datë 14.1.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Illir Toska	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datat 12.11.2025, 19.11.2025 dhe 17.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike dhe mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (I)/II 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: IGOR KOKUNOV, përfaqësuar nga avokatët Isuf Shehu dhe Aureta Ruçi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Elsonida Rama, Roland Stafa dhe Armida Hysenaj, me autorizim.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi si antikushtetues i ekstradimit të Igor Kokunov në Federatën Ruse.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 578, datë 14.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; nr. 591 (30-2024-2077), datë 20.3.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-1533(222), datë 24.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut të aktit të miratimit nr./21 prot./A.H., datë 14.10.2024, të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e Igor Kokunov.

Konstatimi si antikushtetuese i të gjitha veprimeve të kryera nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pas dhënies së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, datë 30.10.2024, ora 17:15, për pezullimin e ekstradimit.

Konstatimi si antikushtetuese i veprimeve të administratës së Gjykatës Kushtetuese të pasqyruara në:

1. Shkresën nr. akti I-8, datë 10.10.2024, të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit.

2. Shkresën nr. akti I-8, datë 17.10.2024, të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 6, 18, 21, 25, 27, 39, pika 2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për Ekstradimin (*Konventa për Ekstradimin*) e datës 13.12.1957 dhe shtesa e saj e datës 15.3.1975; Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); Konventa e Gjenevës “Për statusin e refugjatëve”, datë 28.7.1951 dhe Protokollin i *New York*-ut, në lidhje me



statusin e refugjatëve, datë 31.1.1967; nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Igor Kokunov (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimin këshillimor të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (*KSHH*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari, shtetas rus, ka qenë person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol NCB Moska, mbi bazën e vendimit penal të datës 18.2.2022, të Gjykatës Rajonale të Moskës, Federata Ruse, me të cilin është caktuar ndaj tij masa e sigurimit “Arresti në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Marrja e një pozicioni më të lartë në hierarkinë penale”, të parashikuar nga neni 210.1 i Kodit Penal të Federatës Ruse (*KPR*).

2. Për procedurat e zhvilluara ndaj kërkuarit në Federatën Ruse, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka gjetur, për të gjithë ankuesit, shkelje të nenit 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të paraburgimit dhe për kërkuarin, edhe shkelje të nenit 5, paragrafi 1, për shkak të kufizimit të paligjshëm të lirisë, duke përfshirë ndalimin e paregjistruar dhe pa vendim gjyqësor ose ndonjë bazë tjetër ligjore dhe të nenit 3 të KEDNJ-së, për shkak të përdorimit të kafazeve metalike dhe/ose masave të tjera të sigurisë në sallat e gjyqit (*shih Kokunov e të tjerë kundër Rusisë, aplikimet nr. 54172/20 dhe 6 të tjerë, datë 13 tetor 2022*).

3. Në datën 26.8.2023, në pikën e kalimit kufitar Murriqan, Shkodër, kërkuari është arrestuar gjatë hyrjes në territorin shqiptar, në kushtet e neneve 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

Materialet i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (*Prokuroria e Shkodrës*). Kësaj të fundit, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme i ka përcjellë edhe aktet përkatëse që kishin të bënin me shpalljen e kërkuarit në kërkim ndërkombëtar, me qëllim ekstradimin e tij në Federatën Ruse.

4. Më tej, me kërkesë të prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 482 (3736), datë 29.8.2023, ka vendosur vlefësimin të ligjshëm të arrestimit të përkohshëm të kërkuarit, me qëllim ekstradimin e tij në Federatën Ruse dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” me afat 40-ditor, në pritje të paraqitjes së kërkesës për ekstradim nga autoritetet e drejtësisë ruse dhe, në vijim, me vendimin nr. 576 (4170), datë 4.10.2023, ajo gjykatë ka caktuar ndaj kërkuarit masën e sigurimit “Arresti në burg” pa afat. Ky vendim është miratuar edhe nga gjykatat më të larta.

5. Ndërkohë, në datën 18.9.2023 Prokuroria e Përgjithshme e Federatës Ruse i është drejtuar ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë me kërkesë për ekstradimin e kërkuarit, bazuar në vendimin e Gjykatës Rajonale të Moskës, Federata Ruse. Kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues i janë përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, me shkresën e datës 6.10.2023, e cila, me shkresën e datës 9.10.2023, ia ka dërguar Prokurorisë së Shkodrës. Kjo e fundit, në vijim, i ka kërkuar gjykatës lejimin e ekstradimit të kërkuarit në Federatën Ruse për efekt të zbatimit të vendimit penal të datës 18.2.2022, të Gjykatës Rajonale të Moskës, Federata Ruse.

6. Në datën 3.10.2023, ndërsa kërkuari ndodhej në territorin e Republikës së Shqipërisë prej më shumë se një muaji në paraburgim dhe autoritetet e drejtësisë ruse kishin paraqitur kërkesën për ekstradim, avokati i tij, duke u mbështetur në ligjin nr. 10/2021, datë 1.2.2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 10/2021*), ka paraqitur, për llogari të kërkuarit, një kërkesë për azil pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë.

7. Mbi kërkesën e Prokurorisë së Shkodrës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 578 (4901), datë 14.11.2023, ka vendosur lejimin e ekstradimit të



kërkuesit në Federatën Ruse. Sipas asaj gjykate, kërkesa plotëson kriteret formale dhe ato materiale, e konkretisht: i. urdhërarresti është lëshuar sipas ligjit të shtetit kërkues ndaj ka fuqi për të kërkuar ekstradimin e një shtetasi, sipas nenit 12 të Konventës për Ekstradimin; ii. vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi parashikohet si e tillë edhe nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (KPSH), përkatësisht vepra penale “Organizata kriminale”, e parashikuar nga neni 333, pika 1, i KPSH-së, për të cilën parashikohet dënim me burgim nga 5 deri në 15 vjet; iii. nuk ka arsye të mendohet se kërkuesi do t’u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkaqe të caktuara, por as veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte ose lirie themelore, duke pasur parasysh edhe se ai ka qenë disa herë i dënuar e në masa sigurimi dhe nuk ekziston një precedent i tillë; iv. nuk rezulton që ky shtetas të ketë kryer një vepër penale në Shqipëri; v. nuk rezulton që ndjekja penale ose dënimi të jenë parashkruar sipas ligjeve të Federatës Ruse; vi. plotësohen kushtet sipas nenit 32 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (ligji nr. 10193/2009), pasi në kohën e paraqitjes së kërkesës për ekstradim kërkuesi nuk kishte aplikuar ose nuk i ishte dhënë azil në Shqipëri, ndërsa kërkesa për azil është paraqitur pas kërkesës për ekstradim; vii. kërkesa për ekstradim përmbante aktet shoqëruese të nevojshme. Në datën 19.12.2023 kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

8. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 591 (30-2024-2077), datë 20.3.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 578 (4901), datë 14.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke e gjetur atë në përputhje me ligjin. Gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesi është kapur në kushtet e parashikuara nga nenet 493 dhe 495 të KPP-së, pasi ndaj tij ka një vendim penal për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe urdhërarresti ndërkombëtar. Sipas asaj gjykate, mungesa e një marrëveshjeje dypalëshe nuk paragjykon mundësinë e ekstradimit të të huajit në territorin shqiptar dhe as mundësinë e bashkëpunimit dypalësh. Gjykata e apelit ka vlerësuar se, në të kundërt me sa ka pretenduar mbrojtja e kërkuesit, përmbajtja e nenit 210.1 të KPR-së ka përputhshmëri me përmbajtjen dhe

marzhin e dënimit të nenit 333, pika 1, të KPSH-së, që parashikon veprën penale “Organizata kriminale”. Po sipas saj, nuk rezulton që vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi të jetë e karakterit politik ose ushtarak.

9. Në veçanti, sipas gjykatës së apelit, referuar edhe garancive të dhëna nga autoritetet ruse në kërkesën për ekstradim, sipas kërkesave të nenit 490 të KPP-së, nuk ka arsye të mendohet se kërkuesi do t’u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkaqe të caktuara, dënimeve ose trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese, apo veprimeve që përbëjnë shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Pretendimet në këtë drejtim nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete që lidhen personalisht me kërkuesin dhe nuk japin një përshkrim të saktë dhe të përditësuar të gjendjes për kushtet e paraburgimit në shtetin rus. Sipas saj, kërkuesi ka qenë disa herë i dënuar dhe në masa sigurimi në Federatën Ruse dhe nuk ekziston një precedent i tillë, ndërkohë që vendimi i GJEDNJ-së për atë shtetas nuk ka të bëjë me kushtet e paraburgimit, por me kohëzgjatjen e tij. Po sipas asaj gjykate, i pyetur në seancën e datës 18.3.2024, kërkuesi ka deklaruar se nuk është larguar nga vendi i tij për shkaqet e mësipërme, por për arsye shëndetësore dhe për të marrë trajtim mjekësor. Në lidhje me pretendimin për mosdënimin dy herë për të njëjtën vepër penale, gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk rezulton që kërkuesi të jetë dënuar më parë nga gjykatat shqiptare dhe as të ketë filluar ndonjë procedim penal ndaj tij. Po kështu, gjykata e apelit, referuar datës së paraqitjes së kërkesës për azil tek autoritetet pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë, kërkesë që gjatë gjykimit rezultoi se nuk ishte pranuar dhe shqyrtuar nga autoriteti kompetent, si dhe datës së paraqitjes së kërkesës për ekstradim, e ka gjetur të pabazuar pretendimin se kërkesa për azil është paraqitur përpara kërkesës për ekstradim në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 10193/2009. Në lidhje me gjendjen shëndetësore të pretenduar nga kërkuesi, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjendja fizike nuk përbën shkak për mosekstradim, në kuptim të nenit 491 të KPP-së, duke mos pasur ndikim në pranimin ose jo të kërkesës.

10. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 27.5.2024, kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i asaj gjykate, pas shqyrtimit të çështjes në seancë publike, me vendimin nr. 00-2024-



1533(222), datë 24.9.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave më të ulëta për ekstradimin e kërkuarit në Federatën Ruse, duke i gjetur të pabazuara pretendimet e tij. Ajo gjykatë, pasi ka marrë mendimin e Prokurorisë së Përgjithshme për dy çështje të shtrëna për diskutim, ka trajtuar disa koncepte juridike të institutit të ekstradimit dhe garancive ligjore që ofron legjislacioni ndërkombëtar dhe i brendshëm në raport me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe garancive të shtetasve, vendas ose të huaj, ndaj të cilëve zbatohen procedurat e ekstradimit për jashtë vendit. Në lidhje me pretendimin se ekstradimi nuk plotëson kushtet e nenit 488 të KPP-së dhe se shkresa është nënshkruar nga zëvendësprokurori i Përgjithshëm i Federatës Ruse, u konsiderua se ato nuk ndikojnë në vlefshmërinë e rrugës diplomatike të ndjekur në rastin konkret, për sa kohë që autoriteti kompetent për paraqitjen e një kërkesë të tillë është ky institucion (Prokuroria e Përgjithshme) i Federatës Ruse dhe se autoritetet e atij shteti kanë ndjekur rrugën e duhur për transmetimin e kërkesës për ekstradim, duke vënë në dispozicion të autoriteteve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Po kështu, Kolegji Penal ka vlerësuar se vepra penale për të cilën akuzohet kërkuari, sipas nenit 210.1 të KPR-së, ka përputhshmëri me përmbajtjen dhe marzhin e dënimit të veprës penale të parashikuar nga neni 333, pika 1, i KPSH-së. Kjo veprë penale, sipas Kolegjit Penal, nuk është e karakterit politik ose ushtarak dhe nuk ka asnjë arsye të mendohet se kërkuari do t'u nënshtrohet persekutimeve, diskriminimeve për shkaqe të caktuara, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore, të egra ose poshtëruese apo veprimeve që përbëjnë shkelje të të drejtave themelore të njeriut, ndërkohë që pretendimet e mbrojtjes nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete që lidhen personalisht me kërkuarin dhe nuk japin një përshkrim të saktë dhe të përditësuar të gjendjes për kushtet e paraburgimit në shtetin rus.

11. Sipas Kolegjit Penal, kërkuari ka qenë disa herë i dënuar për vepra penale të një natyre të tillë me atë për të cilën kërkohet ekstradimi, ashtu edhe në masa sigurimi dhe në asnjë rast nuk ekziston një precedent i tillë, ndërkohë që vendimi i GJEDNJ-së që lidhet me kërkuarin nuk ka të bëjë me kushtet e paraburgimit në Federatën Ruse, por me kohëzgjatjen e tij. Lidhur me pretendimin për parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë

penale, ai kolegji ka vlerësuar se kërkuari nuk është dënuar për këto vepra penale më parë në gjykatën kompetente shqiptare dhe as nuk ka filluar procedimi për to në Shqipëri. Për sa i përket kërkesës për azil, sipas Kolegjit Penal, nuk qëndron pretendimi i kërkuarit se ajo është paraqitur përpara kërkesës për ekstradim. Në lidhje me faktin e përjashtimit të Federatës Ruse nga Këshilli i Evropës, Kolegji Penal ka vlerësuar se Konventa për Ekstradimin është e hapur për të marrë pjesë edhe vende jo anëtare të Këshillit të Evropës dhe kjo nuk ndikohet nga statusi i shtetit palë në atë organizëm. Në lidhje me kushtin ndalues të ekstradimit, sipas nenit 32, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10193/2009, ai kolegji ka vlerësuar se nuk mund të pretendohet mbrojtje kur kërkesa për azil është bërë njëkohësisht ose pasi është paraqitur kërkesa për ekstradim, duke e përdorur si një mekanizëm për të ndaluar shqyrtimin e kërkesës për ekstradim. Në këtë kuptim, sipas Kolegjit Penal, rezulton se kërkuari e ka paraqitur kërkesën për azil pas arrestimit të tij, pra pas nisjes *de facto* të procedurës së ekstradimit, ndaj nuk ndodhet përpara kushtit ndalues të ekstradimit.

12. Në datën 9.10.2024, pa pasur ende vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë, kërkuari, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për pezullimin e vendimit të datës 24.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe me kërkesë të po së njëjtës datë ka kërkuar edhe përshpejtimin e shqyrtimit të saj, për shkak të natyrës urgjente të çështjes dhe faktit se zbatimi i vendimit mund t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm të drejtave të tij. Pas kthimit administrativisht të kërkesës për plotësim sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, kjo çështje është regjistruar në Gjykatë në datën 22.10.2024.

13. Ndërkohë, pas përcjelljes nga Prokuroria e Përgjithshme të akteve për procesin e ekstradimit të kërkuarit, përfshirë edhe një kopje të vendimit të shkurtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dispozitivin), ministri i Drejtësisë, në datën 14.10.2024, duke marrë në konsideratë faktin se marrëdhëniet e ekstradimit mes shteteve rregullohen nga Konventa për Ekstradimin, se ekstradimi është kërkuar për vepra penale të parashikuara dhe lejuara nga ajo konventë, duke gjykuar se veprat penale nuk kanë karakter politik dhe nuk ka arsye të mendohet se kërkuari kërkohet për t'i nënshtrohet persekutimit ose diskriminimit për shkaqe të ndryshme, si dhe bazuar në nenin 499 të KPP-së dhe vendimet



gjyqësore që kanë lejuar ekstradimin, ka miratuar, bazuar në parimin e specialitetit, sipas nenit 14 të konventës dhe kuadrit ligjor në fuqi, ekstradimin e kërkuarit nga Shqipëria në Federatën Ruse dhe dorëzimin e tij nga Interpol Tirana brenda datës 30.10.2024.

14. Në datën 30.10.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për pezullim për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 30.10.2024, ora 17:15, referuar edhe informacioneve të marra nga institucionet kompetente se ekstradimi i kërkuarit ishte planifikuar të realizohej në datën 30.10.2024, ora 18:20, bazuar në parashikimet e nenit 45, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, duke vlerësuar se ndodhej në kushtet e urgjencës, si dhe duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara nga kërkuari kanë të bëjnë me pretendime me natyrë kushtetuese, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pezullimin e përkohshëm të procedurave të ekstradimit të kërkuarit deri në një vendimmarrje të dytë të Gjykatës, kohë gjatë të cilës ai do të vijojë të qëndrojë në kushtet e izolimit në pritje të ekstradimit.

15. Po në datën 30.10.2024, në bazë të urdhrit të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), kërkuari i është dorëzuar nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) “Mine Peza”, Tiranë patrullës së shoqërimit të DPB-së, e cila, sipas procesverbalit të dorëzimit, në orën 16:45 ia ka dorëzuar kërkuarin, në aeroportin e Rinasit, përfaqësuesve të Federatës Ruse, me qëllim ekstradimin e tij. Përfundimisht, përmes linjës ajrore, në orën 18:30 (ora lokale) kërkuari është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt Federatës Ruse.

16. Rezulton, gjithashtu, se kërkuari ka paraqitur në GJEDNJ kërkesën nr. 2534/24 kundër Shqipërisë për kundërshtimin e procedurave për ekstradimin e tij, duke kërkuar edhe marrjen e masës së përkohshme, sipas nenit 39 të KEDNJ-së. Në datën 25.10.2024 GJEDNJ-ja ia komunikuar kërkesën shtetit shqiptar, duke i kërkuar informacion, deri në datën 31.10.2024, për planifikimin nga Gjykata të shqyrtimit të kësaj çështjeje, shkak për të cilin, me shkresën e datës 28.10.2024, Avokatura e Shtetit ka kërkuar nga Gjykata informacion dhe kopje të akteve të paraqitura.

17. Në datën 7.2.2025, kërkuari, përmes përfaqësuesit të tij me prokurë, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore dhe të veprimeve të autoriteteve që lejuan ekstradimin e tij në Federatën Ruse.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve, gjatë shqyrtimit të plotësimit të kriterëve të legjitimitetit të kërkuarit, me vendimin e datës 10.4.2025, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim, me qëllim paraqitjen e argumenteve dhe të provave nga kërkuari sesi shqyrtimi i çështjes nga kjo Gjykatë do të mund të rivendoste në vend të drejtat e tij të pretenduara si të shkelura. Në datën 19.5.2025 avokati i kërkuarit, në përputhje me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, ka depozituar parashtrimet e tij në funksion të plotësimit të kërkesës. Në lidhje me këtë të fundit, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 28.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

19. Në datën 21.5.2025, KSHH-ja i është drejtuar Gjykatës, me nismën e saj, duke paraqitur një mendim këshillimor *amicus curiae* për këtë çështje, për të cilin Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 28.5.2025, ka vendosur pranimin e tij. Pas zhvillimit të seancës plenare publike të datës 12.11.2025, KSHH-ja i ka përcjellë Gjykatës informacionin zyrtar që dispononte për procedurën e ekstradimit të kërkuarit, duke paraqitur edhe fotokopje të korrespondencës që ajo ka pasur me Ministrinë e Drejtësisë (shkresa e datës 26.11.2024), Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (shkresa e datës 19.11.2024) dhe Departamentin për Kufirin dhe Migracionin (shkresa e datës 11.12.2024). Në kuptim të neneve 42 dhe 43/b, pika 1, shkronja “c”, të Ligjit Organik të Gjykatës, në kushtet që KSHH-ja nuk është palë në gjykimin kushtetues, për rrjedhojë nuk gëzon të drejtën për të kërkuar ose për të paraqitur prova, dokumentacioni i paraqitur prej saj bashkëlidhur shkresës së datës 17.11.2025 (data e regjistrimit), i është kthyer administrativisht pa veprim.

20. Në seancën plenare publike të datës 19.11.2025 Gjykata ka administruar provat e paraqitura nga palët, si dhe ka deklaruar mbylljen e seancës plenare dhe tërheqjen e trupit gjyqësor për të marrë vendim.

21. Në datën 20.11.2025 është depozituar në Gjykatë shkresa nr. 18974 prot., datë 19.11.2025 e DPB-së drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, përmes së



cilës dërgohet informacion për kërkuesin. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet raporti i sektorit të sigurisë të IEVP-së Malësi e Madhe (Reç) për të paraburgosurin Igor Kokunov, që i përket transferimit të parë të tij të datës 20.9.2023, si dhe memoja e datës 30.11.2023 e DPB-së lidhur me transferimin e këtij të paraburgosuri për arsye sigurie, që i përket transferimit të dytë të tij të datës 30.11.2023. Këto shkresa i janë dërguar Gjykatës edhe përmes postës elektronike nga përfaqësuesi në këtë gjykim i subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë.

22. Gjykata, pasi u njoh me aktet e paraqitura zyrtarisht nga DPB-ja dhe përmes postës elektronike edhe nga subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, për sa kohë ato përmbanin të dhëna dhe informacion për çështjen në shqyrtim, bazuar në nenin 44, pika 1, të Ligjit Organik, vendosi të riçelë seancën plenare dhe zhvillimin e saj mbi bazë të dokumenteve, me qëllim administrimin e këtyre akteve, si dhe vënien në dispozicion të palëve në gjykim për paraqitjen e argumenteve prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

23. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

i. Për legjitimitimin në drejtim të rivendosjes të të drejtave të shkelura:

23.1. Ekstradimi nuk përjashton kontrollin kushtetues, ndaj pavarësisht se kërkuesi është ekstraduar, kjo nuk do të thotë se nuk mund të përfitojë nga një shqyrtim i plotë kushtetues, bazuar edhe në praktikën e Gjykatës që ka pranuar shqyrtimin kushtetues *post facto*. Autoritetet kanë dështuar të garantojnë një vlerësim të plotë dhe real të rrezikut që paraqiste ekstradimi i kërkuesit dhe nuk kanë siguruar garanci të mjaftueshme nga shteti kërkues, çka e bën shqyrtimin e çështjes jo vetëm të mundshëm, por edhe të domosdoshëm për të siguruar rivendosjen e të drejtave kushtetuese të cenuara dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Qëllimi parësor është rivendosja në vend e dinjitetit të kërkuesit.

23.2. Mosgarantimi i pezullimit ka sjellë dëme të drejtpërdrejta pasurore dhe jopasurore, për të cilat do të kërkohet kompensim efektiv. Gjykata në ushtrim të rolit të saj mund të rivendosë të drejtën e cenuar përmes shfuqizimit të vendimeve

antikushtetuese, duke e konsideruar këtë si dëmshpërblim moral të mjaftueshëm. Për më tepër, ekstradimi i kërkuesit ka cenuar edhe të drejtën e tij dhe të familjes për të ruajtur lidhjet familjare në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm. Për pasojë, familjarët kanë të drejtë t'u drejtohen autoriteteve kompetente, gjykatave të zakonshme, për të kërkuar njohjen dhe kompensimin e dëmit në përputhje me parimet e përgjegjësisë shtetërore, si të kërkojnë dëmshpërblim, madje të paraqesin kërkesë në GJEDNJ si “viktima” të shkeljes në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së.

ii. Për themelin

23.3. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

23.3.1. *Së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit,* pasi gjykatat e zakonshme nuk kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura përpara tyre, as ato me natyrë kushtetuese. Vendimet gjyqësore janë alogjike, të pambështetura në të dhëna dhe të paarsyetuara, në zbatim të gabuar të ligjit material e procedural, në kundërshtim me parashikimet e neneve 491 e vijuese të KPP-së, duke mos marrë parasysh as faktin që GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së në rastin e kërkuesit. Meqenëse kërkuesi nuk ka qenë subjekt i keqtrajtimit të mëparshme, kjo nuk dedukton që gjykatat shqiptare të mos marrin në konsideratë mundësinë që ai t'u nënshtrohet atyre në të ardhmen.

23.3.2. *Standardit të arsytimit dhe parimit të identitetit të normave (reciproçiteti i inkriminimeve),* për shkak të arsytimit të gabuar të gjykatave, për sa kohë që vepra penale për të cilën kërkohet kërkuesi nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar, për rrjedhojë nuk plotësohet kushti i kriminalizimit/fajësisë së dyfishtë sipas nenit 11 të KPSH-së dhe nenit 2 të Konventës për Ekstradimin. Gjykatave iu vu në dispozicion kopje e KPR-së dhe përkthimi i nenit 210.1 të saj, duke u pretenduar se nuk korrespondon me nenin 333, pika 1, të KPSH-së. Më këtë të fundit ka ngjashmëri neni 210 i KPR-së, ndërkohë që elementet e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesi, nuk gjenden në ligjin, doktrinën ose jurisprudencën shqiptare. Kodi ynë trajton veprimet kriminale shoqërisht të rrezikshme dhe rrethanat e kryerjes së tyre dhe nuk e njeh nocionin e “hierarkisë kriminale” dhe as të “zënies së një pozicioni të lartë”. KPR-ja bazohet në konceptin e “botës kriminale” dhe perceptimet shoqërore ruse, të cilat nuk kanë përkthim të drejtpërdrejtë në të drejtën penale shqiptare. Po në



drejtim të arsyetimit, gjykatat nuk janë shprehur dhe nuk kanë mbajtur qëndrim për kërkesat, pretendimet dhe të dhënat për ekzistencën e shkaqeve të mosekstradimit, që kanë të bëjnë me të dhënat e raporteve të organizatave ndërkombëtare, raportet mjekësore të kërkuarit, mungesën e plotfuqishmërisë, pasi zëvendësprokurori i Përgjithshëm rus nuk është organi kompetent për të firmosur kërkesën për ekstradim, faktin se Prokurori i Përgjithshëm rus është person *non grata* në Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe në Shqipëri apo praktikën e Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme. Gjykata e Lartë ka referuar me subjektivizëm se kërkuari nuk rrezikonte t'u nënshtrohej persekutimeve ose diskriminimeve, duke e lidhur me faktin se ishte dënuar më parë dhe duke injoruar raportet ndërkombëtare për Federatën Ruse.

23.3.3. *Parimit ex nunc dhe gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi çdo gjetje në raste të tilla lidhur me situatën e përgjithshme në një vend të caktuar dhe dinamikën e tij është në vetvete një vlerësim faktik *ex nunc* që duhet të bëjë gjykata mbi bazën e materialit të disponueshëm, në rastin konkret raportet e organizatave ndërkombëtare për gjendjen e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore në Federatën Ruse. Kërkuari duhej, së paku, të ishte thirrur dhe dëgjuar nga Gjykata e Lartë për të verifikuar nëse ekziston kjo gjendje në atë shtet.

23.4. *E drejta e jetës*, e garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe nenet 2 e 3 të KEDNJ-së. Natyra e shkëlqes që pretendohet është e dyfishtë, nga njëra anë, rreziku për jetën, duke pasur parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore të kërkuarit dhe mungesën e trajtimit mjekësor të përshtatshëm në burgjet ruse (neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së) dhe, nga ana tjetër, rreziku për t'iu nënshtuar torturës ose trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese për shkak të kushteve të paraburgimit dhe dënimit në Federatën Ruse, e konstatuar kjo nga raportet e organizatave, si: *Amnesty International*, *Transparency International*, *Human Rights Watch*, *Freedom House*, Komitetit kundër Torturës, Këshilli i Evropës dhe institucionet e tjera ndërkombëtare që referojnë për torturën dhe keqtrajtimet e të burgosurve në institucionet penitenciare, mungesën e një gjyqësori të pavarur dhe mosgarantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, shkëlqen e të drejtave themelore të njeriut etj. (neni 3 i KEDNJ-së). Po kështu, në njoftimin e datës 3.2.2023 GJEDNJ-ja ka

komunikuar se Federata Ruse nuk është më palë e KEDNJ-së. Këto parashikime ndërveprojnë në mënyrë të pandashme, pasi rreziku për jetën është e pasojë e drejtpërdrejtë e kushteve çnjerëzore të trajtimit në burgjet ruse dhe mungesës së trajtimit mjekësor.

23.5. Shkak për mosekstradimin janë edhe shkaqet humanitare, ku nga doktrina konsiderohem si të tilla edhe mosha e thyer, sëmundjet dhe statusi i refugjatit. Sipas dokumentacionit mjekësor, situata shëndetësore e kërkuarit është e rëndë dhe ai vuan nga disa sëmundje, për të cilat ndihma mjekësore në spitalin e burgut jo gjithnjë mund të jetë në të njëjtin nivel si ajo e institucioneve mjekësore, çka i vështirëson qëndrimin në institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse. Për rrjedhojë, është i pabazuar prapësimi i Prokurorisë së Përgjithshme, pasi situata e rëndë shëndetësore e kërkuarit është dokumentuar që përpara arrestimit në Shqipëri. Kërkuari vuan nga një numër patologjish kardiovaskulare të rënda, me natyrë kronike dhe progresive dhe me rrezikshmëri për jetën, që kërkojnë ndjekje të vazhdueshme dhe trajtim të specializuar. Diagnozat e këtyre sëmundjeve nuk janë emërtime të përgjithshme klinike, por kanë sjellë ndërhyrje të përsëritura dhe kërkojnë ndjekje të specializuar. Gjatë viteve 2015-2017 kërkuarit i janë vendosur shtatë stenda në enët e gjakut dhe në mars të vitit 2020 ishte planifikuar një ndërhyrje tjetër për këtë qëllim. Avokatja e tij ka kërkuar konsultë me një mjek kirurg kardiovaskular, e cila është refuzuar me vendimin e datës 12.10.2020 të hetuesit të departamentit të hetimit, çka dëshmon pamundësinë reale të sistemit rus për të garantuar aksesin në trajtim të specializuar edhe kur gjendja e kërkuarit e dikton domosdoshmërisht këtë. Përkundrejt prapësimit të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, se kërkuari nuk ka paraqitur asnjë ankesë ose provë për gjendjen shëndetësore gjatë qëndrimit në Shqipëri, mbrojtja e tij ka ndjekur të gjitha kanalet institucionale për të garantuar të drejtat që burojnë nga ligji shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, konkretisht duke paraqitur kërkesa në Ministrinë e Drejtësisë, Avokatin e Popullit, prokurori, IEVP dhe DPB për ekzaminimin mjekësor për të identifikuar gjendjen e tij shëndetësore nga specialistët e fushës dhe kalimin pranë Qendrës Spitalore të Burgjeve. Në shkresën e datës 22.7.2024 Avokati i Popullit i ka rekomanduar DPB-së transferimin e kërkuarit dhe trajtimin në



Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve, Tiranë. Në kërkesën për ekstradim nuk ka informacion specifik për institucionin e paraburgimit ku do të mbahej kërkuesi në Federatën Ruse, por referuar gjendjes në institucionet e paraburgimit në atë shtet konstatohet në mënyrë të përsëritur shkelja e të drejtave dhe lirive themelore.

23.6. Gjykatat kanë pasur në dispozicion të gjitha të dhënat dhe dokumentet e paraqitura edhe në gjykimin kushtetues, por edhe pse kanë pasur mundësinë reale dhe të plotë të vlerësojnë çdo element faktik e juridik, kanë injoruar çdo pretendim. Në juridiksione të tjera instrumente si *amicus curiae* ose mekanizma të tjerë të paraqitjes së informacionit nga burime të sigurta dhe të besueshme përdoren për të ndihmuar gjykimin. Edhe pse të dhënat ishin të pranishme dhe të aksesueshme, gjykatat kanë dështuar të sigurojnë mbrojtjen efektive të të drejtave themelore të kërkuarit.

23.7. *Parimet e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit*, pasi qëndrimi i Gjykatës së Lartë devijon në mënyrë të dukshme nga qëndrimet e mbajtura në rastet e mëparshme të ekstradimit, me objekt dhe bazë ligjore të njëjtë, duke krijuar kontradiktë në qasjen e saj dhe duke gjykuar me dy standarde. Ajo gjykatë ka refuzuar në disa raste të ngjashme ekstradimin në Republikën e Kinës, të Koresë së Jugut dhe të Turkmenistanit, duke u bazuar mbi argumente të cilat janë injoruar dhe nga të cilat është devijuar në rastin e kërkuarit. Ky parim është shkelur edhe nga Ministria e Drejtësisë që në rastin e një shtetasi tjetër rus ka mbajtur qëndrim të kundërt, duke mos lejuar vijimin e procedurave të ekstradimit.

23.8. *Parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike*, pasi kërkesa për ekstradim është nënshkruar nga autoriteti jokompetent, në kuptim të nenit 2 të protokollit të katërt shtesë të Konventës për Ekstradimin, verifikim që nuk është bërë as nga ministria, as nga prokuroria apo gjykatat. Nëse autoriteti kompetent nuk është Ministria e Drejtësisë e Federatës Ruse, konfirmimi për këtë duhet të vijë drejtpërdrejt nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Por, edhe nëse pranohet se autoriteti kompetent është Prokurori i Përgjithshëm, kërkesa është nënshkruar nga zëvendësprokurori i Përgjithshëm pa pasur ai një akt delegimi. Po kështu, Prokurori i Përgjithshëm i Federatës Ruse është në “Listën e zezë” të publikuar nga SHBA-të, status që

ka shumë rëndësi për ligjshmërinë e kërkesave ndërkombëtare.

23.9. *E drejta për azil* e njohur nga Konventa e Gjenevës e vitit 1951, në lidhje me statusin e refugjatëve. Në datën 3.10.2023, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për azil përpara organeve kompetente, për shkak të frikës se nëse kthehet në Federatën Ruse do të persekutohet për shkak të gjendjes personale dhe shoqërore. Parimi i moskthimit, i sanksionuar në nenin 33 të asaj konvente, ndalon çdo shtet që të kthejë një individ në një vend ku mund të përballet me rrezik persekutimi ose trajtime çnjerëzore, ndërkohë që sipas VKM-së nr. 601, datë 14.9.2022, Federata Ruse nuk është përfshirë në listën e vendeve të treta të sigurta. Parimi i moskthimit garantohet edhe në nenin 11 të ligjit nr. 10/2021, kurse neni 54 i tij parashikon të drejtën e kërkuarit për të qëndruar në Shqipëri deri në përfundimin e procedurave për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare. Edhe pse në datën 3.10.2023 i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin që të mundësohej intervistimi i kërkuarit në ambientet e paraburgimit, kjo kërkesë mbeti pa përgjigje, duke u cenuar e drejta për shqyrtim të plotë dhe të drejtë e kërkesës për azil.

23.10. *Detyrimi për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës*, pasi edhe pse institucionet janë informuar për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekstradimit, ato nuk e kanë marrë parasysh detyrimin për të mos ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim dhe procedura është bërë në fshehtësi, me qëllim ekstradimin pa pritur vendimin e Gjykatës. Nga informacioni i DBP-së kërkuesi është transportuar për në aeroport në orën 16:30, përpara se Gjykata të shprehej për pezullimin. Avokati i kërkuarit, pasi u njoftua në orën 18:08 përmes *e-mail*-it për masën e pezullimit, u nis për në aeroport dhe njoftoi strukturat përkatëse në përpjekje për pezullimin e procedurës, por nuk mori asnjë përgjigje. Dorëzimi i kërkuarit nga DPB-ja është bërë 1 orë e 35 minuta përpara orarit të parashikuar në aktin e ministrit dhe përpos kësaj avioni është larguar 1 orë me vonesë. Pretendimet e subjekteve të interesuara për njoftimin dhe ekzekutimin e vendimit të pezullimit të ekstradimit janë të pabazuara. Pretendimi se njoftimi elektronik i kryer pas orës 16:30 nuk është i vlefshëm, bie ndesh me nenin 57, shkronja “d”, të Kodit të Procedurave Administrative. Institucionet publike janë të detyruara të organizojnë punën për



të garantuar zbatimin e menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës.

24. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar, si vijon:

24.1. Pretendimi se kërkesa për ekstradim është nënshkruar nga autoriteti jokompetent sipas protokollit shtesë të Konventës për Ekstradimin është i pabazuar. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror, administron procedurën e ekstradimit dhe verifikimi i autoritetit qendror kërkues bëhet sipas listës së autoriteteve qendrore dhe kompetente, të depozituar në Sekretariatin e Këshillit të Evropës, në kuadër të instrumenteve të ratifikimit. Federata Ruse ka deklaruar në konventë se autoriteti qendror është Prokuroria e Përgjithshme. Edhe neni 6, pika 2, i protokollit të katërt shtesë të konventës parashikon se shfrytëzimi i Interpolit ose kanaleve diplomatike nuk përjashtohet. Rruga e transmetimit është në përputhje me konventën.

24.2. Për sa i përket verifikimit të kushteve të ekstradimit, Ministria e Drejtësisë ka konkluduar se nuk kanë qenë kushtet sipas nenit 491, shkronja “b”, të KPP-së që nuk lejojnë ekstradimin. Ministria e Drejtësisë fillimisht verifikon nëse shteti ndaj të cilit janë ngritur pretendimet është shtet palë i konventës që ka për objekt të drejtat që pretendohen të cenuara. Ndalimi i trajtimit degradues dhe torturës në burgje janë objekt i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Torturës, në të cilën Federata Ruse ishte palë deri në tetor 2024 dhe denoncimi i saj ka hyrë në fuqi më 30.10.2025, çka do të thotë që garancia për trajtimin në burgje është anëtarësia në momentin që është lejuar ekstradimi. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror në procedurën e ekstradimit, komunikon vetëm me autoritetet gjyqësore dhe shqyrton dokumentacionin që i vë në dispozicion vetëm gjykata ose Prokuroria e Përgjithshme, por nuk gjykon dhe nuk ndërhyr në asnjë fazë të shqyrtimit gjyqësor. Prokuroria e Përgjithshme e Federatës Ruse ka dhënë garancitë e nevojshme për respektimin e të drejtave të shtetasit rus dhe për trajtimin e tij në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966, ku ai shtet është palë.

24.3. Për sa i përket afatit për disponimin e ekstradimit, Ministria e Drejtësisë i është referuar datës kur vendimi përfundimtar i gjykatës ka marrë formë të prerë, për sa kohë neni 499 i KPP-së nuk

lë vend për interpretim kur shprehet për afatin 30-ditor dhe pasojat në rast se nuk disponohet brenda tij. Vendimi përfundimtar është baza për arsyetimin e disponimit të ministrit dhe në rast se ai ka konfirmuar vendimet e mëparshme, nuk është i nevojshëm një vendim i arsyetuar që i referohet të njëjtut arsyetim të gjykatave më të ulëta. Në çdo rast, çdo subjekt ka të drejtë të ushtrojë ankimin kushtetues, ndërkohë që njoftimi i vendimeve që mund të përbëjnë shkak për pezullimin e procedurës duhet të bëhet përpara disponimit dhe dorëzimit të menjëhershëm, me qëllim shqyrtimin e faktit dhe marrjen e vendimit për pezullim.

24.4. Për sa i përket ekzekutimit të vendimit për pezullimin e ekstradimit, kërkimi i informacionit nga Gjykata në datën 30.10.2024 nuk nënkupton marrjen dijeni për procedurën që po zhvillohej prej saj. Komunikimi elektronik i vendimit të pezullimit përmes postës elektronike është bërë në orën 17:54, jashtë orarit zyrtar të punës së administratës publike dhe struktura përkatëse që duhej të trajtonte rastin nuk ka qenë në zyrë. Njoftimi pas orarit zyrtar të ditës së punës nuk konsiderohet i kryer dhe prezumohet mosnjoftimi. Procesimi me karakter ekzekutiv i këtij vendimi nënkupton kryerjen e veprimeve administrative që parashikojnë përfshirjen e disa strukturave deri në momentin e vendimmarrjes nga ministri, veprime që kanë qenë të pamundura të kryhen nga momenti i njoftimit të vendimit kabinetit të ministrit dhe deri në orën e planifikuar për ekstradim, 18:20. Pas marrjes dijeni për vendimin e Gjykatës është komunikuar me telefon me ministrin e Drejtësisë, i cili në atë moment nuk ndodhej në zyrat e ministrisë dhe po me telefon është komunikuar me Interpolin, që ka informuar se kërkuesi i ishte dorëzuar palës ruse. Vendimmarrja për pezullim nga ministri kërkon përmbushjen e disa hapave proceduralë dhe administrativë sipas linjës hierarkike dhe, më pas, hartimin e vlerësimit dhe shkresave përkatëse të cilat kalojnë, po sipas linjës hierarkike, deri te ministri si autoriteti vendimmarrës. Më tej, vendimmarrja duhet t’u komunikohet institucioneve që administrojnë dorëzimin e subjektit, DPB-së dhe Interpolit, të cilat duhet të marrin masat përkatëse. Në kohën e njoftimit të vendimit të Gjykatës kërkuesi ishte dorëzuar tashmë tek autoritetet ruse. Planifikimi i transportimit të kërkuesit në zbatim të aktit të miratimit të ekstradimit është kryer konform praktikës dhe procedurës së Interpolit dhe



dispozitave konventore e ligjore dhe nuk kushtëzohet nga asnjë akt i pritshëm gjyqësor.

24.5. Sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 19 të Konventës për Ekstradimin, juridiksioni i autoriteteve shqiptare mbaron në momentin e dorëzimit palës kërkuese. Teksti i konventës i referohet vetëm termit “dorëzim” dhe jo në kuptimin e largimit të personit nga territori i shtetit të kërkuar. E njëjta terminologji gjendet edhe në dispozitat e KPP-së, të ligjit nr. 10193/2009 dhe të Traktatit Model për Ekstradimin, i cili përdor termin “surrender”, që në gjuhën shqipe do të thotë “dorëzim”. Në kuptim të këtyre dispozitave, dorëzimi i personit është momenti final i përfundimit të procedurës së ekstradimit dhe as Konventa për Ekstradimin, as legjislacioni i brendshëm nuk e lidh atë me territorin e Republikës së Shqipërisë ose daljen nga territori. Ky është edhe treguesi që përcakton se cili autoritet ka juridiksion, çka do të thotë se kur dorëzimi kryhet, autoritetet shqiptare nuk kanë më juridiksion, pasi ai i kalon shtetit kërkuar. Vetëm nëse ky i fundit nuk vepron në afatin e caktuar për marrjen në dorëzim të të ekstraduarit, autoritetet shqiptare vijojnë të kenë juridiksion mbi shtetasin, që konkretizohet me lirin e tij. Dorëzimi i kërkuarit përcakton momentin kur autoritetet shqiptare kanë humbur juridiksionin. Dalja nga territori i shtetit të kërkuar është në dorën e shtetit kërkuar, i cili merr masat për të planifikuar dhe për të larguar personin që ekstradohet, ndaj çdo vonesë eventuale në largimin nga territori nuk mund të përbëjë shkak për rimarrjen e juridiksionit nga autoritetet shqiptare. Njoftimi i përfaqësuesit të subjektit për ekstradimin nuk parashikohet në aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, por Ministria e Drejtësisë komunikon me autoritetet qendrore dhe gjyqësore. Vendimmarrja për ekstradimin dhe autorizimi i institucioneve nuk përmbajnë detaje logjistike të dorëzimit, por ai kryhet nga interpolet përkatëse, ku përfshihet marrja e masave, si linjat ajrore, oraret e fluturimit dhe emrat e oficerëve të autorizuar. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës për pezullimin nuk ka ardhur nga ndonjë veprim ose mosveprim i Ministrisë së Drejtësisë, por si pasojë e pamundësisë efektive, pasi kërkuari ishte dorëzuar zyrtarisht te autoritetet e shtetit kërkuar.

24.6. Lidhur me të drejtën e azilit, Ministria e Drejtësisë nuk ka informacion për statusin e azilit në Shqipëri në asnjë fazë të procedurës së ekstradimit.

25. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar, si vijon:

25.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit është i pabazuar. Proceset gjyqësore të shqyrtimit të ekstradimit nuk janë procese të mirëfillta gjyqësore, por kanë të bëjnë me vlerësimin e kushteve lejuese dhe ndaluese të ekstradimit, bazuar në praktikën dokumentare të përcjellë nga shteti kërkuar. Gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim parashikimet e neneve 489–491 të KPP-së për procedurën dhe kushtet e ekstradimit, faktet e parashtruara në praktikën e ekstradimit dhe kanë analizuar e arsyetuar nëse plotësohen kushtet lejuese ose ndaluese të parashikuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, vlerësim që nuk mund të bëhet objekt i gjykimit kushtetues. Gjykatat kanë evidentuar pretendimet e kërkuarit dhe u kanë dhënë atyre përgjigje të arsyetuar.

25.2. Në rastin e institutit të ekstradimit legjislacioni jonë operon me dy lloj kushtesh të ndryshme për nga natyra: neni 11, pika 3, i KPSH-së dhe neni 491 i KPP-së operojnë me konceptin e “ndalimit të ekstradimit” kur plotësohet një nga kushtet e parashikuara, ndalim që përjashton diskrecionin gjyqësor; neni 11, pikat 1 e 2, i KPSH-së dhe neni 490 i KPP-së operojnë me konceptin “lejohet me kusht”, raste që nuk gëzojnë peshën dhe rëndësinë e të parave dhe vërtetimi i tyre mbart elemente të diskrecionit të Gjykatës. Kjo do të thotë se mosvërtetimi i një kushti për lejimin e ekstradimit nuk është i barabartë me vërtetimin e një kushti për ndalimin e tij dhe nuk mund të interpretohet si i tillë. Për rrjedhojë, nëse Gjykata do të ketë një vlerësim të ndryshëm, do të duhet të zgjerojë objektin e gjykimit dhe të nisë gjykimin incidental për kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore.

25.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës së jetës është i pabazuar, pasi mbështetet në argumentin se kërkuari vuan nga sëmundje të cilat nuk mund të trajtohen në kushtet e izolimit. Gjatë kohës që kërkuari ka qëndruar në IEVP, ai nuk ka pasur pretendime të natyrës shëndetësore dhe as nuk ka ndonjë provë ose pretendim se diagnozat e tij mjekësore janë të papërshtatshme me kushtet e paraburgimit, se mund të cenojnë jetën e tij dhe se për nga natyra sëmundjet nga të cilat vuan nuk mund të trajtohen në sistemin e burgjeve, në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe neneve 2 e 3 të



KEDNJ-së. Problematikat që mund të ketë Federata Ruse në drejtim të trajtimit të personave të cilëve u është hequr liria janë një tregues i përgjithshëm dhe kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë se sëmundjet e tij mund t'i rrezikojnë jetën në sistemin rus të paraburgimit, çka mund të përbënte shkak që gjykatat të bënin verifikime. Asnjë e dhënë nuk provon se shëndeti i tij është përkeqësuar për shkak të qëndrimit në paraburgim në masën që të vlerësohet rrezik për jetën. Kërkuesi është me precedentë penalë dhe ka vuajtur edhe më parë dënime në Federatën Ruse. Pyetjes së gjykatës së zakonshme për arsyet e largimit nga Federata Ruse kërkuesi i është përgjigjur se nuk lidheshin me frikën se kishte arsye të mendonte se do t'u nënshtrohej persekutimeve ose diskriminimeve apo trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese, ose shkeljeve të të drejtave ose lirive themelore, por me nevojën për mjekimin e duhur të problemeve shëndetësore, të cilin nuk mund ta merrte në shtetin e tij. Në seancën plenare të datës 12.11.2025, përpara Gjykatës, përfaqësuesi i kërkuesit ka pohuar se ai ka ardhur në Shqipëri për arsye turistike, për rrjedhojë ka shkelur me vullnetin e tij masën e sigurimit të dhënë nga autoritetet ruse. Evidentohet, gjithashtu, se autoritetet në Federatën Ruse nuk e kishin vendosur kërkuesin në institucionet e paraburgimit, por në kushtet e shtëpisë, pra ai nuk vinte nga kushte keqtrajtimi ose persekutimi.

25.4. Praktika e ekstradimit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në tri shkallë gjykimi dhe është në diskrecionin e gjykatave të zakonshme të vlerësojnë dhe vendosin, rast pas rasti, nevojën për marrjen e informacioneve shtesë nëse, sipas nenit 491, shkronja “b”, të KPP-së, ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve. Gjykatat, pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, kanë arsyetuar e vlerësuar se nuk ka pasur arsye të mendojnë se ai do t'u nënshtrohej shkeljeve të të drejtave themelore. Vlerësimi i tyre nuk mund të lidhet me faktin e përjashtimit të Federatës Ruse nga Këshilli i Evropës, pasi rezolutat e Komitetit të Ministrave dhe pasojat e përjashtimit lidhen dhe kanë ardhur si pasojë e veprimeve ushtarake të Federatës Ruse kundër Ukrainës, dhe jo me sistemin e saj penitenciar. Ndërkohë, Federata Ruse vazhdon të jetë palë e Konventës për Ekstradimin, e cila nuk ndikohet nga statusi i shtetit palë në Këshillin e Evropës.

25.5. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi verifikimi i kushteve për lejin ose jo të ekstradimit bëhet rast pas rasti, referuar dokumentacionit shoqërues të kërkesës për ekstradim. Secila kërkesë për ekstradim ka natyrë të veçantë dhe nuk mund të pretendohet zgjidhje e njëjtë për çdo kërkesë, edhe nëse paraqitet nga i njëjti shtet, por vlerësimi mbetet në diskrecion të Gjykatës.

25.6. Pretendimi se *kërkesa për ekstradim nuk është nënshkruar nga autoriteti kompetent* është i pabazuar. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se Ministria e Drejtësisë ka informuar gjykatën e shkallës së parë se Prokuroria e Përgjithshme e Federatës Ruse është autoriteti kompetent për përcjelljen e kërkesës dhe të dokumentacionit, duke dhënë konfirmimin në këtë drejtim. Ky pretendim është marrë në shqyrtim nga gjykatat dhe i është dhënë përgjigje shteruese. Praktika e ekstradimit përmbush kërkesat formale dhe detyrimet ligjore dhe nënshkrimi nga zëvendësprokurori i Përgjithshëm nuk ndikon në vlefshmërinë e rrugës diplomatike, për sa kohë kërkesa është paraqitur nga institucioni përkatës dhe nënshkruar në emër të atij institucioni.

25.7. Edhe pretendimi për *të drejtën e azilit* është shqyrtuar nga gjykatat, veçanërisht nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se kërkesa për azil nuk mund të jetë kusht ndalues për ekstradimin e kërkuesit. Procedurat e azilit nuk mund të prevalojnë mbi procedurat penale dhe thjesht depozitimi i kërkesës për azil nuk përbën kusht ndalues ose pezullues për ekstradimin. Vetëm pranimi i kërkesës për azil do të përbënte shkak ndalues, ndërkohë që nuk rezulton një vendimarrje pozitive për atë kërkesë. Edhe nëse do të ishte vërtetuar fakti i pretenduar, është gjykata që ka diskrecion për të vlerësuar nëse pengohet ekstradimi. Parashikimi në nenin 32, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10193/2009 duhet të interpretohet si paraqitje e kërkesës së shtetit kërkues në shtetin e kërkuar dhe në këtë moment nuk përfshihet periudha e qarkullimit të kërkesës në institucionet shqiptare. Kërkesa për ekstradim është paraqitur përpara kërkesës për azil, pra përpara nisjes *de facto* të procedurës së ekstradimit.

25.8. Për sa i përket moszbatimit të vendimit të Gjykatës për pezullimin e ekstradimit, procedura e ekstradimit është në diskrecion të Ministrisë së Drejtësisë, pavarësisht vendimarrjeve të gjykatave. Afati 30-ditor, sipas nenit 499 të KPP-së, fillon nga



dita që vendimi merr formë të prerë dhe ai prevalon ndaj rregullimeve ligjore që parashikojnë afate që përfshihen në afatin e përgjithshëm 30-ditor. Ministri ka të paktën 10 ditë për të disponuar ose jo për ekstradimin nga momenti kur prokurori përmbush detyrën për dorëzimin e dokumentacionit pranë tij. Për ministrin e Drejtësisë është e rëndësishme të verifikojë që është bërë kontrolli gjyqësor i kërkesës dhe se ai ka përfunduar. Për të arritur në përfundimin se ky afat lidhet me datën e shqiptimit të vendimit dhe jo atë të depozitimit të vendimit të arsyetuar, ai duhet të analizohet edhe në lidhje me parashikimet e KPP-së për detyrimin e gjykatave për dorëzimin në sekretari të vendimit të arsyetuar. Për sa i përket ankimit kushtetues individual, kjo e drejtë është e garantuar përderisa personi mund t'i drejtohet Gjykatës dhe ajo të vendosë pezullimin e ekstradimit. Kjo masë e përkohshme procedurale paraqitet si një mjet ligjor që garanton efektivitetin e ankimit kushtetues. Megjithatë, ligji nuk ka parashikuar situatën kur gjatë shqyrtimit të kërkesës për pezullim dhe ankimit kushtetues përfundon afati 30-ditor.

26. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar, si vijon:

26.1. Kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e tij në nivel kushtetues, por është përqendruar në mënyrën sesi është realizuar gjykimi në Gjykatën e Lartë. Kërkuesi ka kryer një vepër penale të rëndë në vendin e tij dhe ekziston një interes i lartë për të mbrojtur sigurinë e qytetarëve. Atij nuk do t'i mohohet e drejta për proces të rregullt ligjor në vendin e tij dhe ai nuk duhet të trajtohet ndryshe nga individë të tjerë që janë ekstraduar për krime të ngjashme. Pezullimi i vendimit sjell rrezikun që individ i të largohet dhe t'i shmanget drejtësisë, duke dëmtuar procesin në Federatën Ruse, ndërsa ekstradimi tregon angazhim për bashkëpunim në luftën kundër krimit.

26.2. Në datën 30.10.2024, ora 16:45, drejtoria e Interpolit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10193/2009, shkresës së datës 14.10.2024 të ministrit të Drejtësisë për miratimin e ekstradimit të kërkuesit, si dhe parashikimeve të rregullores së brendshme të datës 4.6.2024, ka kryer procedurat e dorëzimit të kërkuesit tek oficerët e policisë ruse të

ngarkuar për këtë qëllim. Për rrjedhojë, në rastin konkret janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

27. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, nenit 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

28. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës përfshihen edhe të huajt, sikurse është dhe kërkuesi në këtë gjykim. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se në aspektin procedural kërkuesi rezulton se ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se individ mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se në situatën që vendimet objekt të ankimit kushtetues individual që kanë lejuar ekstradimin e kërkuesit nga shteti shqiptar për në Federatën Ruse janë ekzekutuar tashmë mbi bazën e urdhrit të ministrit të Drejtësisë dhe kërkuesi është ekstraduar efektivisht në datën 30.10.2024, ajo



duhet të ndalet në vlerësimin nëse kërkuesi ka ende një interes të njohur në çështjen në fjalë.

29. Gjykata, në parim, vlerëson se përjashtimi i një kërkese/ankimi nga kontrolli kushtetues, vetëm për shkak se masa e kundërshtuar ka përfunduar, rrezikon të zvogëlojë në mënyrë të paarsyeshme nivelin e mbrojtjes të të drejtave themelore që synon të garantojë ky mjet, duke vënë në dyshim edhe efektivitetin e tij. Për këtë arsye, **interesi për ankimin kushtetues** konsiderohet se mbetet, sidomos kur ndërhyrja e pretenduar në të drejtat ose liritë themelore është **veçanërisht e rëndë** dhe/ose kur akti i autoritetit publik **e konsumon efektin e tij në një afat aq të shkurtër**, sa e bën praktikisht të vështirë sigurimin në kohë të një vendimi nga Gjykata sipas rregullave të saj të gjykimin. Kjo qasje vlen posaçërisht në procedura si ato për lejimin e ekstradimit, ku rregullimi ligjor dhe afatet procedurale mund të sjellin ekzekutimin e masës përpara se kontrolli kushtetues të mund të ushtrohet në mënyrë efektive.

30. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë në një rast të ngjashëm me atë të këtij gjykimi. Në atë rast, ajo gjykatë ka shqyrtuar ankimin kushtetues kundër vendimit të gjykatës së zakonshme gjermane për lejimin e ekstradimit në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 4 të Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, analog me nenin 3 të KEDNJ-së (për ndalimin e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore ose degraduese), edhe pse në kohën e paraqitjes së ankimit kushtetues ankuesi i ishte dorëzuar tashmë shtetit kërkues (autoriteteve hungareze) në bazë të një urdhërarresti evropian. Sipas asaj gjykate, pavarësisht se masa e kundërshtuar ka përfunduar, interesi ligjor i ankuesit për paraqitjen e ankimit kushtetues mbetet, sepse përndryshe do të pamundësohej sqarimi i një çështjeje thelbësisht të rëndësishme kushtetuese dhe sepse ndërhyrja e pretenduar në të drejtat themelore duket veçanërisht e rëndë dhe vijon ende, për sa kohë kërkuesi vazhdon të mbahet i izoluar në një burg hungarez. Për më tepër, për shkak të afatit kohor operativ brenda të cilit kishte ndodhur dorëzimi, vendimi i kundërshtuar i kishte dhënë tashmë efektet, çka bëri praktikisht të pamundur që ankuesi të merrte në kohë një vendim për ankimin e tij kushtetues. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë ka konstatuar se vendimi i gjykatës së

zakonshme, që ka lejuar dorëzimin e ankuesit tek autoritetet ligjore hungareze, ka shkelur të drejtën e tij themelore sipas nenit 4 të Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale 2 BVR 1103/24, datë 24.1.2025, paragrafi 55*).

31. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual dhe argumentet mbi të cilat ato mbështeten, si dhe duke pasur parasysh se vendimet për lejimin e ekstradimit kanë prodhuar tashmë efektin e tyre, pasi kërkuesi është ekstraduar në Federatën Ruse, Gjykata vlerëson se ai nuk ka në dispozicion mjete të tjera efektive që bëjnë të mundur, në rrethanat konkrete, kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore të dhëna në çështjen e tij. Nga ana tjetër, edhe pse një vendim i favorshëm i Gjykatës nuk pritet të prodhojë pasoja të drejtpërdrejta për mënyrën e trajtimit të kërkuesit gjatë qëndrimit të tij në institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse, ai mund të sigurojë forma të tjera të përshtatshme të rivendosjes të të drejtave, përfshirë, së paku, konstatimin e shkeljes dhe masat riparuese që parashikon rendi juridik. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi ruan interesin për vënien në lëvizje të këtij gjykimi dhe mundet të pretendojë se është “viktimë” e shkeljes. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*.

32. Në lidhje me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata vëren se kërkuesi, formalisht, i është drejtuar asaj pasi ka shteruar më parë, në formë dhe substancë, mjetet e zakonshme të ankimit, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për azil, të njohur nga Konventa e Gjenevës e vitit 1951, duke pretenduar, nga njëra anë, se mosveprimi i autoriteteve kompetente për të lejuar dhe mundësuar intervistimin e tij në kuptim të ligjit nr. 10/2021 ka cenuar të drejtën për shqyrtim të plotë dhe të drejtë të kërkesës për azil në Shqipëri dhe, nga ana tjetër, se paraqitja e kërkesës për azil përbënte kusht ndalues për lejimin e ekstradimit.

33. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, vëren se në datën 3.10.2023 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për azil pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë, kërkesë e cila, sipas informacionit të dërguar nga kjo e fundit, është



dërguar me postë nga avokati i kërkuarit dhe është protokolluar në datën 5.10.2023. Me kërkesën e datës 3.10.2023, avokati i kërkuarit ka kërkuar nga autoritetet e IEVP-së “Jordan Misja”, Tiranë që në kuptim të nenit 30 të ligjit 10/2021 të mundësonin kryerjen e intervistës së kërkuarit në ambientet e paraburgimit, në datën dhe orën që shihej e arsyeshme. Me shkresën e datës 5.10.2023, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin ka përcjellë për kompetencë pranë Drejtorisë së Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, në Ministrinë e Brendshme, kërkesën e kërkuarit për azil. Kjo e fundit, me shkresën “Kthim përgjigje” të datës 20.10.2023, drejtuar Departamentit për Kufirin dhe Migracionin dhe për dijeni përfaqësuesit të kërkuarit, ka informuar se bazuar në ligjin nr. 10/2021, kërkesa do të shqyrtohej nga autoriteti përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, pasi të kategorizohej si azilkerkues nga Autoriteti përgjegjës për Kufirin dhe Migracionin, i cili është autoriteti kompetent për procedurën e përzgjedhjes për të huajt që kërkojnë azil. Në datën 13.12.2023 kërkuari u është drejtuar autoriteteve të IEVP-së “Mine Peza”, Tiranë me kërkesë për t’u shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Tiranë për kryerjen e intervistës, me qëllim garantim e së drejtës për azil dhe ndjekjen e rregullt të procedurave. Me shkresën e datës 7.11.2024, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë i ka kthyer përgjigje përfaqësuesit të kërkuarit se Autoriteti për Kufirin dhe Migracionin do të regjistrojë kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare me praninë fizike të shtetasit të interesuar, bazuar në pikën 7 të nenit 26 të ligjit nr. 10/2021, sipas së cilës, kërkuari, në momentin e paraqitjes së kërkesës, plotëson formularin, ku përfshihen marrja e gjurmëve daktiloskopike, e fotografisë dhe dëshmime të tjera në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

34. Për sa më sipër, Gjykata vëren se pavarësisht komunikimeve të kryera nga kërkuari/përfaqësuesi i tij me autoritetet kompetente për trajtimin e kërkesës për azil dhe ato të institucioneve të paraburgimit, ajo kërkesë është konsideruar se nuk ka plotësuar aspektet formale, për rrjedhojë, referuar qëndrimin të mbajtur nga autoritetet kompetente sipas ligjit nr. 10/2021, është konsideruar sikur të mos ishte paraqitur asnjëherë dhe në këto kushte nuk është marrë asnjëherë në shqyrtim lidhur me bazueshmërinë e saj. Në këtë situatë, Gjykata

vlerëson se edhe pse kërkuari, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka pretenduar në procesin gjyqësor të kundërshtuar që gjykatat të vlerësonin edhe faktin se ishte paraqitur një kërkesë për azil dhe pasojat e saj në procedurën e ekstradimit, ai nuk ka përdorur ndonjë nga mjetet ligjore në dispozicion me qëllim shqyrtimin administrativ të kërkesës për azil. Edhe pse kërkuari, sipas ligjit të veçantë, kishte mjete juridike në dispozicion, ai nuk rezultoi t’u jetë drejtuar gjykatave të zakonshme për kundërshtimin e veprimit refuzues të autoriteteve administrative për regjistrimin e kërkesës për azil dhe për detyrimin e tyre për regjistrimin e saj, marrjen e masave për intervistimin e tij dhe në vijim shqyrtimin në themel të kërkesës për azil. Nga ana tjetër, në ankimin kushtetues kërkuari nuk ka provuar dhe as nuk ka pretenduar se përdorimi i mjeteve të tilla do të ishte joefektiv për mbrojtjen e të drejtave të tij. Vetëm faktet se kërkuari gjatë procesit gjyqësor objekt kërkesë ka parashtruar si shkak për moslejimin e ekstradimit paraqitjen e kërkesës për azil dhe se gjykatat e zakonshme e kanë shqyrtuar atë, duke vlerësuar se kërkesa për azil është paraqitur në një moment kohor të mëvonshëm sesa kërkesa për ekstradim, nuk janë të mjaftueshme në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve për marrjen në shqyrtim të pretendimit kushtetues substancial për të drejtën për azil. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në lidhje me këtë pretendim kërkuari nuk ka shteruar mjetit juridike, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim. Për sa u përket pretendimeve të tjera të paraqitura në ankimin kushtetues, kërkuari rezultoi t’i ketë paraqitur ato më parë në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme.

35. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë ndaj tij, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 24.9.2024, ndërsa kërkuari i është drejtuar Gjykatës fillimisht në datën 9.10.2024, me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe më pas, pas komunikimit të vendimit të arsyetuar të asaj gjykate në datën 21.10.2024 përmes postës elektronike, përfaqësuesi i kërkuarit ka paraqitur ankimin kushtetues të datës 7.2.2025, me objekt dhe shkaqe si më sipër.



36. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka ngritur përpara Gjykatës pretendime që kanë të bëjnë si me cenimin e *së drejtës për proces të rregullt*, në disa aspekte të saj, ashtu edhe me të *drejtën e jetës, parimet e barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit, të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike*, si edhe detyrimin kushtetues për *ekzekutimin e vendimit të Gjykatës*.

37. Gjykata çmon të theksojë, fillimisht, se ekstradimi jashtë territorit rregullohet nga neni 39, pika 2, i Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuara, KPSH-ja dhe KPP-ja, ndërsa rregullat plotësuese janë parashikuar edhe në ligjin nr. 10193/2009. Referuar kuadrit ligjor, procesi i ekstradimit për jashtë shtetit ka natyrë të dyfishtë, duke qenë pjesërisht administrativ për sa i përket veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe pjesërisht gjyqësor, pasi ai mund të lejohet vetëm me vendim gjyqësor, ku në rastin e lejitimit është ministri i Drejtësisë ai që disponon përfundimisht për ekstradimin ose jo të një shtetasi. Qëllimi i ankimit kushtetues individual dhe interesi i kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për lejitimitet e ekstradimit dhe të procesit të ekstradimit është pikërisht garantimi i së drejtës për të mos u ekstraduar (*shih vendimin nr. 70, datë 6.11.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson të theksojë se kontrolli i saj gjatë këtij gjykimi kushtetues, në parim, nuk ndalet në natyrën dhe hapësirën e veprimtarisë së organit administrativ, pra në lidhje me vlerësimet diskrecionare që i janë besuar Ministrisë së Drejtësisë gjatë procedurës që kryhet pas dhënies së vendimit gjyqësor, duke qenë se këto çështje nuk mund të jenë objekt i kontrollit gjyqësor. Megjithatë, për sa kohë që në rastin konkret vihet në diskutim edhe standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimit të Gjykatës, me të cilin u urdhërua të mos merrej asnjë veprim për ekstradimin e kërkuesit, vlerësimi i mënyrës sesi kanë vepruar organet administrative të përfshira në procedurën e ekstradimit do të vihet në diskutim vetëm në këtë drejtim dhe vetëm me qëllim verifikimin e respektimit të këtij detyrimi kushtetues.

38. Në lidhje me pretendimin për mosëkzekutimin e vendimit të Gjykatës për pezullimin e ekstradimit, në objektin e ankimit kushtetues është kërkuar edhe konstatimi si antikushtetuese i të gjitha veprimeve të kryera nga institucionet përgjegjëse pas dhënies së vendimit për

pezullimin e ekstradimit, përfshirë veprimet e administratës së Gjykatës të pasqyruara në shkresat nr. akti I-8, të datave 10.10.2024 dhe 17.10.2024 të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit. Në lidhje me këtë kërkim, nga njëra anë, jo vetëm që nuk është parashtruar asnjë argument për lidhjen mes këtyre shkresave, të cilat i referohen komunikimit të administratës së Gjykatës me përfaqësuesin e kërkuesit, dhe procedurave të ekstradimit të kundërshtuara si jokushtetuese, por, nga ana tjetër, zbatimi dhe interpretimi i rregullave të gjykimit kushtetues, përfshirë ato për regjistrimin e kërkesave dhe shqyrtimin paraprak e gjykimin e tyre i përket vetëm Gjykatës. Për sa kohë që ky kërkim i kërkuesit nuk është shoqëruar me pretendime për shkelje kushtetuese, ai nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi.

39. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit ex nunc* në kuadër të së drejtës për proces të rregullt dhe gjykimit nga një gjykatë e paanshme, Gjykata vëren se ai ka të bëjë në thelb me vlerësimin e pretendimeve për të drejtën e jetës, ndaj do të shqyrtohet në këtë këndvështrim.

40. Në drejtim të pretendimit për cenimin e *standardit të arsyetimit dhe parimit të identitetit të normave (reciprociteti i inkriminimeve)*, kërkuesi ka pretenduar edhe se vepra penale për të cilën ai kërkohet nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar dhe se neni 210 i KPR-së, i referuar përpara gjykatave, ka ngjashmëri në elementet objektive dhe subjektive me nenin 333, pika 1, të KPSH-së, ndërkohë që elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 210.1 i KPR-së nuk gjenden në nenin 333, pika 1, të KPSH-së dhe në asnjë dispozitë tjetër të këtij kodi, i cili nuk e njeh nocionin e “hierarkisë kriminale” dhe as të “zënies së një pozicioni të lartë”. Sipas nenit 2, paragrafi 1, të Konventës për Ekstradimin, i japin shkas ekstradimit veprat penale që ndëshkohen nga ligjet e palës kërkuese dhe të palës së kërkuar me privimin e lirisë ose me një masë sigurimi privuese të lirisë. Në të njëjtën mënyrë edhe neni 11, paragrafi i dytë, i KPSH-së ka parashikuar se ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është e parashikuar si e tillë njëkohësisht si nga ligji shqiptar dhe ai i huaj. Gjykatat e zakonshme, në kuptim të këtij parashikimi, si dhe referuar përmbajtjes së dispozitës penale materiale për të cilën akuzohet kërkuesi, kanë vlerësuar se për nga përmbajtja e saj dhe marzhi i dënimit vepra penale sipas nenit 210.1 të KPR-së ka



përputhshmëri me veprën penale “Organizata kriminale”, të parashikuar nga neni 333, pika 1, i KPSH-së. Sipas gjykatave, kërkesa për ekstradim dëshmon se ndaj kërkesit është regjistruar një procedim penal në Federatën Ruse, që do të thotë se ai dyshohet të ketë kryer vepra penale të dënueshme nga legjislacioni penal material rus, të cilat janë njëherazi të dënueshme edhe nga legjislacioni penal shqiptar. Për pasojë, vlerësimi i gjykatave në këtë drejtim, për sa kohë është një çështje që ka të bëjë ekskluzivisht me ushtrimin e kompetencave të tyre dhe në situatën që arsyetimi i vendimeve në këtë drejtim nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar, nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues.

41. Kërkesi ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit*, pasi qëndrimi i Gjykatës së Lartë ka devijuar dukshëm nga qëndrimet e mbajtura në raste të mëparshme të ekstradimit. Gjykata në raste të tilla ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethanat, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim të këtyre standardeve, në rastin konkret nuk pretendohet që Gjykata e Lartë të ketë vendosur në mënyrë të ndryshme me ndonjë vendim unifikues a njësuës të praktikës gjyqësore, për rrjedhojë vetëm fakti që Kolegji Penal i asaj gjykate mund të ketë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, nuk përbën argument të mjaftueshëm që mund të mbështesë pretendimin e kërkesit nga pikëpamja kushtetuese.

42. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimeve të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike*, sipas kërkesit, kërkesa për ekstradim është nënshkruar nga autoriteti jokompetent, duke vënë në diskutim në këtë drejtim jo vetëm nëse autoriteti kompetent, sipas nenit 2 të protokollit të katërt shtesë të Konventës për Ekstradimin, është Prokurori i Përgjithshëm i Federatës Ruse, por edhe mungesën

e delegimit për zëvendësprokurorin e Përgjithshëm, i cili ka nënshkruar kërkesën në rastin konkret. Sipas kërkesit, në momentin që vjen një kërkesë për ekstradim duhet të verifikohet nëse është nxjerrë nga autoriteti përkatës, verifikim që nuk është bërë as nga Ministria e Drejtësisë, as nga prokuroria ose gjykatat. Po sipas tij, Prokurori i Përgjithshëm i Federatës Ruse është në “Listën e zezë” të publikuar nga SHBA-të, status që ka shumë rëndësi për ligjshmërinë e kërkesave ndërkombëtare.

43. Referuar përmbajtjes së nenit 2 të protokollit të katërt shtesë të Konventës për Ekstradimin, ai parashikon formën e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentet mbështetëse të saj. Sipas kësaj dispozite, kërkesa me shkrim paraqitet nga ministri i Drejtësisë ose një autoritet tjetër kompetent i palës kërkuese dhe se një shtet që dëshiron të përcaktojë një autoritet tjetër nga ministri i Drejtësisë duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për autoritetin kompetent në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, verifikimi i autoritetit qendror kërkuës bëhet sipas listës së autoriteteve qendrore dhe kompetente, të depozituar në Sekretariatin e Këshillit të Evropës, në kuadër të instrumenteve të ratifikimit dhe se Federata Ruse ka deklaruar në konventë se autoriteti qendror është Prokuroria e Përgjithshme. Po kështu, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, konstatohet se me shkresën e datës 6.11.2023, Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të shkresës së datës 26.10.2023, të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për autoritetin kompetent për të përcjellë kërkesën për ekstradim e kërkesit, ka informuar atë gjykatë se Prokuroria e Përgjithshme e Federatës Ruse është autoriteti kompetent për këtë qëllim sipas Konventës për Ekstradimin.

44. Për sa më sipër, në ndryshim nga sa pretendon kërkesi, si Ministria e Drejtësisë, ashtu edhe gjykatat kanë verifikuar, përveç formës së paraqitjes së kërkesës për ekstradim, edhe kompetencën e organit që ka paraqitur kërkesën në kuptim të Konventës për Ekstradimin. Referuar edhe praktikave të tjera të mëparshme me atë shtet, të cilat janë paraqitur në procesin kushtetues nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se komunikimet mes palëve janë kryer në emër të Federatës Ruse nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas GJEDNJ-së, në çështjet e ekstradimit, shënimet diplomatike janë



mjete standarde për shtetin që bën kërkesën për të dhënë çdo siguri, të cilën shteti të cilit i është paraqitur kërkesa, e konsideron të nevojshme për të dhënë miratimin e tij për ekstradim dhe ato mbartin një supozim të mirëbesimit (*shih Rrapo kundër Shqipërisë, datë 25.9.2012, § 72*). Për rrjedhojë, për sa kohë që kërkesa është paraqitur nga autoriteti kompetent, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata nuk ka arsye të vërë në diskutim autorizimin e personit që e ka nënshkruar atë si përfaqësues i shtetit kërkuar, në kuptim të kriterëve dhe kushteve që përcakton Konventa e Ekstradimit. Për më tepër, ky pretendim është marrë në shqyrtim edhe nga gjykatat e zakonshme, të cilat i kanë kthyer përgjigje të arsyetuar kërkuar se pretendimi i tij në këtë drejtim nuk ndikon në vlefshmërinë e rrugës diplomatike të ndjekur në rastin konkret. Referuar atij arsyetimi nuk konstatohet ndonjë gabim serioz për të vënë në dyshim interpretimin e ligjit që ato u kanë bërë fakteve të çështjes së kërkuar. Në këto kushte, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

45. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues rezulton se kërkuar ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* në drejtim të *së drejtës së aksesit, të ankimit dhe standardit të arsyetimit*, pasi gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura përpara tyre, që kanë të bëjnë me shkaqet e mosekstradimit dhe ai nuk ka marrë përgjigje as për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në Gjykatën e Lartë. Sipas tij, vendimet gjyqësore janë alogjike, të pambështetura në të dhëna dhe të paarsyetuara, në zbatim të gabuar të ligjit material e procedural, në kundërshtim me parashikimet e neneve 491 e vijuese të KPP-së, duke mos marrë parasysh as faktin që GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së në rastin e kërkuar. Kërkuar ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së jetës*, pasi, sipas tij, ekzistojnë shkaqe dhe arsye të rëndësishme shëndetësore që i rrezikojnë jetën në Federatën Ruse, referuar raporteve të besueshme dhe ndërkombëtare që dokumentojnë gjendjen e të drejtave të njeriut në atë shtet, si dhe faktit se Federata Ruse nuk është më palë e KEDNJ-së. Sipas tij, shkak për mosekstradimin ishte fakti se ai vuan nga disa sëmundje, për të cilat ndihma mjekësore në spitalin e burgut jo gjithnjë mund të jetë në të njëjtin nivel si ajo e ofruar në institucionet mjekësore, çka vështirëson qëndrimin e tij në

institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse, e provuar kjo me diagnozat e sëmundjeve.

46. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë argumentet e kërkuar në këtë drejtim, vlerëson se ato kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues, të parashikuar në nenin 25 të Kushtetutës, lidhur me mosrespektimin e të drejtave të njeriut në institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse, ku ai është ekstraduar me qëllim ekzekutimin e vendimit për caktimin e masës së arrestit në burg të dhënë nga autoritetet ruse. Gjykata, duke pasur parasysh se e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, vlerëson se ky pretendim do të shihet i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore në këndvështrim të mënyrës sesi gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar dhe argumentuar pretendimet e kërkuar për cenimin e nenit 25 të Kushtetutës.

47. Për sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë në vijim, në drejtim të bazueshmërisë së tyre në themel, pretendimet e kërkuar për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues, të parashikuar në nenin 25 të Kushtetutës, të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si dhe për mosrespektimin e detyrimit kushtetues për ekzekutimin e vendimit të kësaj Gjykate sipas nenit 132, pika 1, të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

48. Sipas kërkuar, ekzistojnë shkaqe dhe arsye të rëndësishme shëndetësore që rrezikojnë jetën e tij në Federatën Ruse, referuar raporteve të besueshme që dokumentojnë gjendjen e të drejtave të njeriut në atë shtet, të organizatave, si *Amnesty International*, *Transparency International*, *Human Rights Watch*, *Freedom House* e të tjera, të cilat evidentojnë, mes të tjerash, torturën dhe keqtrajtimet e të burgosurve në institucionet e paraburgimit, mungesën e një gjyqësori të pavarur dhe mosgarantin e së drejtës për një gjykim të drejtë, si dhe shkeljen e të drejtave themelore të njeriut. Sipas tij, referuar raporteve mjekësore, ai vuan nga disa sëmundje për të cilat ndihma mjekësore në spitalin e burgut jo gjithnjë



mund të jetë në të njëjtin nivel si ajo e ofruar në institucionet mjekësore, çka i vështirëson qëndrimin në institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse. Kërkuesi ka pretenduar se situata e tij e rëndë shëndetësore është dokumentuar që përpara transferimit të tij në Shqipëri dhe se, sipas dokumentacionit mjekësor, ai vuan nga një numër patologjik kardiovaskular të rënda, me natyrë kronike dhe progresive, që kërkojnë ndjekje të vazhdueshme dhe trajtim të specializuar. Diagnozat e sëmundjeve nga të cilat ai vuan, vijon kërkuesi, nuk janë emërtime të përgjithshme klinike, por janë materializuar në ndërhyrje të përsëritura dhe kërkojnë domosdoshmërisht ndjekje të specializuar, ku për këtë arsye, gjatë viteve 2015-2017, atij i janë vendosur shtatë stenda në enët e gjakut dhe në mars të vitit 2020 ishte planifikuar një ndërhyrje tjetër për këtë qëllim. Po kështu, është pretenduar se avokatja e kërkuesit në Federatën Ruse ka kërkuar konsultë me një mjek kirurg kardiovaskular, e cila është refuzuar me vendimin e datës 12.10.2020 të hetuesit të departamentit të hetimit, çka, sipas kërkuesit, dëshmon për pamundësinë reale të sistemit rus për të garantuar qasjen në trajtim të specializuar edhe kur gjendja e tij e dikton domosdoshmërisht këtë. Sipas kërkuesit, është objektivisht e pamundur që ai të “mbijetojë” në kushtet dhe trajtimin që ofron paraburgimi në Federatën Ruse. Në këtë drejtim, ai ka pretenduar se gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura përpara tyre dhe se nuk ka marrë përgjigje as për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese të ngritura në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që vendimet gjyqësore janë alogjike, të pambështetura në të dhëna dhe të paarsyetuara, në zbatim të gabuar të ligjit material e procedural, në kundërshtim me parashikimet e neneve 491 e vijuese të KPP-së.

49. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, për sa i përket verifikimit të kushteve të ekstradimit, ky institucion ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i kërkuesit dhe ka konkluduar se nuk kanë qenë kushtet sipas nenit 491, shkronja “b”, të KPP-së që nuk lejojnë ekstradimin. Sipas këtij subjekti, Ministria e Drejtësisë fillimisht verifikon nëse shteti ndaj të cilit janë ngritur pretendimet është shtet palë i konventës që ka për objekt të drejtat që pretendohen të cenuara. Kështu, ndalimi i trajtimit degradues dhe torturës në burgje është objekt i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Torturës, në të cilën

Federata Ruse ka qenë palë deri në tetor 2024 dhe denoncimi i saj nga kjo konventë ka hyrë në fuqi më 30.10.2025, çka do të thotë që garancia për trajtimin në burgje është anëtarësia në momentin që u lejua ekstradimi. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror në procedurën e ekstradimit, komunikon vetëm me autoritetet gjyqësore dhe shqyrtton dokumentacionin që i vihet në dispozicion nga gjykata ose Prokuroria e Përgjithshme, por ajo nuk gjykon dhe nuk ndërhyr në asnjë fazë të shqyrtimit gjyqësor. Po sipas këtij subjekti, Prokuroria e Përgjithshme e Federatës Ruse, në kërkesën për ekstradim, ka dhënë garancitë e nevojshme për respektimin e të drejtave dhe për trajtimin e kërkuesit në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966, ku ai shtet është palë.

50. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se kërkuesi ka kryer një vepër penale të rëndë në vendin e tij dhe ekziston një interes i lartë për të mbrojtur sigurinë e qytetarëve dhe se ai nuk duhet të trajtohet ndryshe nga individë të tjerë që janë ekstraduar për krime të ngjashme.

51. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, ky pretendim është i pabazuar, pasi mbështetet në argumentin se kërkuesi vuan nga sëmundje të cilat duhet të trajtohen me ndihmën e duhur mjekësore që, sipas tij, nuk mund të realizohet në kushtet e izolimit. Po sipas këtij subjekti, gjatë kohës që kërkuesi ka qëndruar në IEVP-të në Shqipëri, nuk ka asnjë provë ose pretendim se trajtimi mjekësor i gjendjes së tij shëndetësore ishte i papajtueshëm me kushtet e paraburgimit dhe se mund të cenonte jetën e tij, në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Paraqitja e problematikave që mund të ketë Federata Ruse në drejtim të trajtimit të personave të cilëve u është hequr liria, sipas këtij subjekti, përbën tregues të përgjithshëm. Po sipas tij, gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka ngritur asnjë pretendim se natyra e sëmundjeve nga të cilat ai vuan nuk mund të trajtohen në sistemin e burgjeve, si dhe nuk ka paraqitur prova se këto sëmundje mund të rrezikojnë jetën e tij në sistemin rus të paraburgimit, çka do të mund të përbente shkak që gjykatat të bënin verifikime shtesë. Ky subjekt ka prapësuar se asnjë e dhënë nuk provon se shëndeti i kërkuesit është përkeqësuar për shkak të qëndrimit në



paraburgim në masën që të vlerësohet rrezik për jetën, ndërkohë që kërkuesi është me precedentë penalë dhe ka vuajtur edhe më parë dënime në atë shtet.

52. Në opinionin e saj këshillimor KSHH-ja është shprehur se vendimi i GJEDNJ-së për kërkuesin, i vitit 2023, kundër Federatës Ruse, ka konkluduar shkëljen e neneve 3 dhe 5 të KEDNJ-së, që lidhen me dinjitetin njerëzor, ndaj Gjykata do të duhej të bënte interpretimin e të drejtave të tij nisur nga ky fakt i natyrës kushtetuese. Sipas saj, ka dyshime të arsyeshme edhe në themelësinë e pretendimeve për të drejtat substanciale të individit, që kërkojnë vëmendje në respektim të standardeve kushtetuese.

53. Sipas nenit 25 të Kushtetutës, askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor poshtërues. Gjykata ka theksuar se qëllimi i këtyre parashikimeve është mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizik e mendor të individit, ndaj është detyrë e shtetit që të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet masave legjislative ose masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara të torturës ose keqtrajtimit nga individët ose zyrtarët publikë (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2004, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket zbatimit të nenit 3 të KEDNJ-së, i cili parashikon se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtërues, GJEDNJ-ja ka theksuar se ekstradimi mund të ngrejë një çështje sipas kësaj dispozite dhe, për këtë arsye, të passjellë përgjegjësinë e atij shteti sipas konventës, kur ka arsye të konsiderueshme për të besuar se individ, nëse ekstradohet, do të përballlet me një rrezik real të nënshtimit ndaj trajtimit në kundërshtim me nenin 3 (*shih Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 7.7.1989, § 91*). GJEDNJ-ja ka konstatuar në disa raste se transferimi i një individ që vuan nga një sëmundje e rëndë nuk do të ishte në shkëlje të neneve 2 dhe 3 të KEDNJ-së, për aq sa është bindur se, në përputhje me ligjin dhe procedurën e brendshme, një urdhër largimi nuk do të zbatohet nëse individ nuk do të gjendej i aftë nga ana mjekësore për transferim (*shih Al-Zavatia kundër Suedisë, nr. 50068/08, datë 22.6.2010, § 58; Karim kundër Suedisë, nr. 24171/05, datë 4.7.2006; Imamovic kundër Suedisë, nr. 57633/10, datë 13.11.2012*).

54. Për të përcaktuar nëse është provuar se kërkuesi përballlet me një rrezik real nëse ekstradohet, GJEDNJ-ja e vlerëson çështjen në

dritën e të gjithë dokumentacionit të paraqitur përpara saj dhe, nëse është e nevojshme, edhe atij të marrë *proprio motu* (*shih Tersbiyev kundër Azerbajxhanit, nr. 10226/13, datë 31.7.2014, § 48; López Elorza kundër Spanjës, nr. 30614/15, datë 12.12.2017, § 106*). Meqenëse natyra e përgjegjësisë së shteteve sipas nenit 3 të KEDNJ-së në raste të këtij lloji qëndron në ekspozimin e një individ ndaj rrezikut të keqtrajtimit, ekzistenca e këtij rreziku duhet të vlerësohet kryesisht duke iu referuar atyre fakteve që ishin të njohura ose duhej të ishin të njohura në kohën e ekstradimit (*shih Kislov kundër Rusisë, nr. 3598/10, datë 9.7.2019, § 79*). Për të përcaktuar nëse ekziston rreziku i keqtrajtimit, Gjykata duhet të shqyrtojë pasojat e parashikueshme të ekstradimit në vendin kërkues, duke pasur parasysh situatën e përgjithshme atje dhe rrethanat e individit (*shih Sanchez-Sanchez kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 22854/20, datë 3.11.2022, § 85*). Lidhur me shpërndarjen e barrës së provës, sipas asaj gjykate, vlerësimi i ekzistencës së një rreziku real duhet domosdoshmërisht të jetë rigoroz. Në parim, i takon kërkuesit që të paraqesë prova për të vërtetuar se ka arsye të konsiderueshme për të besuar se, nëse masa do të zbatohet, ai do të ekspozohet ndaj një rreziku real për t'iu nënshtuar trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të konventës. Kur janë paraqitur prova të tilla, i takon qeverisë të largojë çdo dyshim në këtë drejtim (*shih WA dhe të tjerë kundër Italisë, nr. 18787/17, datë 16.11.2023, § 87*). Në rastet kur ka bazë të konsiderueshme në këtë drejtim, shqyrtohet nëse ndonjë garanci e marrë ka qenë e mjaftueshme për të eliminuar çdo rrezik real të keqtrajtimit, duke theksuar në këtë drejtim se garancitë diplomatike nuk janë, në vetvete, të mjaftueshme për të siguruar mbrojtje të përshtatshme kundër rrezikut të keqtrajtimit dhe se ekziston një detyrim për të shqyrtuar nëse ato sigurojnë, gjatë zbatimit të tyre, se kërkuesi ka mbrojtje kundër një rreziku të tillë (*shih Othman (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8139/09, datë 17.1.2012, § 187; Yefimova kundër Rusisë, nr. 39786/09, datë 19.2.2013, § 202*).

55. Sipas GJEDNJ-së, referenca ndaj një problemi të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend të caktuar nuk mund të shërbejë, në vetvete, si bazë për refuzimin e ekstradimit të një personi të caktuar nëse, edhe kur raportet ndërkombëtare vazhdojnë të shprehin shqetësime serioze në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në një shtet të caktuar, nuk ka asnjë tregues



se kjo është mjaftueshëm serioze për të justifikuar një ndalim të plotë të ekstradimit në atë vend. GJEDNJ-ja ka përcaktuar disa kritere që duhen përdorur në vlerësimin e cilësisë së garancive të dhëna, në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes në fjalë, duke përfshirë, ndër të tjera: i. kush ka dhënë garancitë dhe nëse ai person/autoritet ka fuqinë për të detyruar qeverinë e shtetit pritës; ii. nëse ato janë të formuluar në terma të përgjithshëm ose specifike, dhe nëse janë dhënë nga një shtet palë; iii. nëse pajtueshmëria e shtetit kërkues me këto garanci mund të kontrollohet në mënyrë objektive përmes mekanizmave diplomatikë ose të tjerë monitorues, për shembull, duke i siguruar kërkuesit akses të pakufizuar tek avokati; iv. nëse ekziston një sistem efektiv mbrojtjeje kundër torturës në shtetin pritës, duke përfshirë nëse është i gatshëm të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit (*shih Kunshugarov kundër Turqisë, nr. 60811/15 dhe 54512/17, datë 14.11.2025, §§ 117, 122*).

56. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi, si bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, ashtu edhe në gjykimin në gjykatat e zakonshme, ka paraqitur disa dokumente që referojnë gjendjen e tij shëndetësore dhe trajtimet mjekësore e spitalore, përfshirë disa ndërhyrje të kryera, për shkak të problemeve që e kanë shoqëruar ndër vite. Në datën 28.5.2024, ndërsa kërkuesi ndodhej i izoluar në IEVP-në “Mine Peza”, Tiranë, ai i është drejtuar me një ankesë Avokatit të Popullit për gjendjen e tij shëndetësore dhe psikosociale. Pas këqyrjes së kartelës klinike të kërkuesit dhe bazuar në diagnozat, ekzaminimet laboratorike dhe terapinë për të, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 81, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i është drejtuar DPB-së me rekomandimin e datës 16.7.2024, për marrjen e masave të menjëhershme për transferimin e kërkuesit dhe trajtimin e tij në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve, Tiranë. Gjykata, referuar akteve të këtij gjykimi, vëren se edhe pse kërkuesi vuan nga disa problematika shëndetësore, ku përfshihen ato kardiologjike dhe të diabetit, për të cilat ka kryer ndërhyrje dhe u është nënshtruar ekzaminimeve klinike, gjendja e tij rezulton të jetë e qëndrueshme dhe është rekomanduar vijimi i terapisë me barnat e përshkruara, si dhe ndjekja ambulatorie. Edhe gjatë qëndrimit të tij në ambientet e paraburgimit në

Shqipëri, kërkuesi u është nënshtruar kontrolleve mjekësore dhe ekzaminimeve të mjekëve, nga të cilat ka rezultuar se parametrat jetësorë kanë qenë brenda vlerave normale, duke u rekomanduar vazhdimi i trajtimit sipas terapive me barnat e përshkruara. Në këtë kuptim, referuar akteve dhe të dhënave të paraqitura nga kërkuesi, Gjykata vëren se pretendimet në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore nuk janë të tilla që të mund të vënë në diskutim respektimin e së drejtës së jetës në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së. Këto pretendime, për sa kohë që nuk është arritur të provohet pamundësia e trajtimit të këtyre problematikave në izolim, apo pamundësia e trajtimit të tyre nga autoritet ruse gjatë kohës që kërkuesi është në izolim, nuk janë të tilla që të kalojnë barrën e provës të autoritetet lidhur me vlerësimin e pretendimeve për ekzistencën e rreziqeve dhe pasojave për jetën e kërkuesit. Për rrjedhojë, bazuar në vlerësimin e gjendjes mjekësore të kërkuesit dhe zhvillimeve të saj deri në momentin e shqyrtimit të kërkesës së tij, nuk rezulton ekzistenca e rreziqeve specifike të vërtetuara, me natyrë të përkohshme ose të përhershme, të cilat do të mund të sillnin pasoja në drejtim të jetës së tij.

57. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, Gjykata vlerëson se duhet të ndalet në vijim edhe në pretendimin e kërkuesit për gjendjen e të drejtave të njeriut në shtetin kërkues, duke konsideruar se kjo përbën jo vetëm ndalim sipas nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 3 të KEDNJ-së, por edhe një nga kushtet ndaluese për lejimin e ekstradimit në kuptim të nenit 491, shkronja “b”, të KPP-së.

58. Gjykata vëren sesi në ankimin kushtetues, ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e zakonshme, përfaqësuesi i kërkuesit ka paraqitur pretendime në këtë drejtim, duke paraqitur edhe akte, raporte dhe të dhëna që referojnë për gjendjen e të drejtave të njeriut në Federatën Ruse. Sipas këtyre të dhënave, rezulton se sipas raportit të Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara të datës 15.9.2023, legjislacioni i fundit në Federatën Ruse ka kufizuar ashpër mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sipas raportit të Amnesty International të datës 13.11.2023, veçanërisht nga viti 2021 situata e të drejtave të njeriut në Federatën Ruse është përkeqësuar thellësisht në mënyrë domethënëse dhe është bërë edhe më e rëndë. Raporti i Këshillit për të Drejtat e Njeriut i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të



Bashkuara i datës 5.10.2023 thekson rëndimin e mëtejshëm të situatës në drejtim të të drejtave të njeriut në Federatën Ruse dhe shpreh shqetësim të thellë për arrestimet arbitrare, izolimin dhe persekutimin e individëve të caktuar. Po kështu, sipas informacionit të datës 30.10.2022 të shoqatave të shoqërisë civile në Federatën Ruse, i përgatitur për OSBE-në, është evidentuar vazhdimësia e shkeljeve të të drejtave të njeriut në atë shtet. Nga ana tjetër, sipas një njoftimi të publikuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale (Gjykata e Hagës), është lëshuar urdhërarresti edhe për Presidentin e Federatës Ruse në kontekstin e situatës në Ukrainë. Po kështu, në datën 7.3.2022, me një dekret të Këshillit të Ministrave të Federatës Ruse, është shpallur lista e vendeve armiqësore me atë shtet, në të cilën bën pjesë edhe Shqipëria. Në vijim, rezulton se Federata Ruse është përjashtuar nga Këshilli i Evropës në datën 16.3.2022, ndërsa nga data 16.9.2022 ajo **ka pushuar së qeni palë e KEDNJ-së, sipas** njoftimeve zyrtare nga organet e Këshillit të Evropës dhe nga vetë GJEDNJ-ja. Rezulton, gjithashtu, se sipas VKM-së nr. 601, datë 14.9.2022, “Për miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta”, Federata Ruse nuk bën pjesë në këtë listë.

59. Referuar vendimeve të gjykatave të zakonshme, ato kanë marrë në shqyrtim edhe pretendimet për kushtet në burgjet ruse dhe nivelin e respektimit nga autoritetet ruse të të drejtave të njeriut. Sipas gjykatës së apelit, pretendimet e kërkuarit nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete dhe, për më tepër, referuar kërkesës për ekstradim të datës 18.9.2023, autoritetet ruse kanë siguruar se kërkesa për ekstradim nuk ka për qëllim përndjekjen e kërkuarit për arsye politike, për shkak të racës, fesë kombësisë ose pikëpamjeve politike dhe se do t'i ofrohen të gjitha mundësitë për mbrojtje, përfshirë ndihmën e avokatëve, se ky shtetas nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues dhe se ai do të ndiqet penalisht vetëm për krimin për të cilin kërkohet ekstradimi dhe se, pas përfundimit të gjykimit dhe në rast të një vendimi fajësie, pas vuajtjes së dënimit ose lirimit, ai do të mund të largohet nga territori rus. Gjithashtu, sipas gjykatës së apelit, shteti rus ka garantuar se, në rast ekstradimi, kërkuari do të mbahet në një institucion që merr parasysh standardet e përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të datës 16 dhjetor 1966, duke dhënë edhe garancinë se

punonjësit e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë do të mund ta vizitojnë atë për të monitoruar respektimin e këtyre garancive. Po sipas gjykatës së apelit, kërkuari ka qenë disa herë i dënuar dhe në masa sigurimi, e në asnjë rast nuk ekziston një precedent i tillë i pretenduar për trajtimin e tij.

60. Ky pretendim është marrë në shqyrtim edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vlerësuar, në të njëjtën mënyrë si gjykata e apelit, se shteti rus ka dhënë garanci se kërkuari nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues dhe se ai do të ndiqet penalisht vetëm për krimin për të cilin kërkohet ekstradimi, se pas përfundimit të gjykimit dhe në rast të një vendimi fajësie, pas vuajtjes së dënimit ose lirimit, ai do të mund të largohet nga territori rus, si dhe se ai do të mbahet në një institucion që merr parasysh standardet e përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të datës 16 dhjetor 1966. Po sipas Kolegjit Penal, i pyetur nga gjykata e apelit për arsyet e largimit nga shteti rus, ku ishte nën masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, kërkuari nuk e ka lidhur këtë me frikën se kishte arsye të mendonte se do t'u nënshtrohej persekutimeve ose diskriminimeve, por me nevojën për mjekimin e duhur të problemeve shëndetësore, duke pretenduar se nuk mund të merrte një mjekim të tillë në shtetin e tij.

61. Gjykata konstaton se gjatë shqyrtimit të kërkesës për ekstradim të kërkuarit, autoritetet kompetente të përfshira në këtë procedurë, ashtu edhe gjykatat, janë vënë në mënyrë të mjaftueshme dhe të plotë në dijeni të fakteve që tregonin për rrezikun real të trajtimit të shtetasve nga Federata Ruse, e lidhur kjo me respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, duket se ato janë mbështetur kryesisht në garancitë e dhëna nga autoritetet ruse, pa u ndalur vetë në verifikimin e këtyre pretendimeve. Sipas GJEDNJ-së, vetëm referenca ndaj ligjeve të brendshme dhe traktateve ndërkombëtare që garantojnë respektimin e të drejtave themelore nuk mund të ofrojë, në vetvete, një garanci të mjaftueshme kundër rrezikut të keqtrajtimit, veçanërisht kur burimet kanë dokumentuar praktikatat e përdorura ose të toleruara nga autoritetet, të cilat shkelin hapur parimet e konventës (*shih Hirsi Jamaa dhe të tjerë kundër Italisë [DhM], nr. 27765/09, ECHR 2012, § 128; Klein kundër Ruisë, nr. 24268/08, datë 1.4.2010, § 55*). Për sa u përket garancive të dhëna në kërkesën për



ekstradim, Gjykata vëren se ato jo vetëm që janë formuluar në mënyrë të përgjithshme, por edhe se, në rrethanat e rastit konkret, vihet në diskutim besueshmëria e tyre. Gjykata vëren se garancitë janë dhënë nga një shtet që nuk është më anëtar i Këshillit të Evropës dhe as palë e KEDNJ-së, si dhe se ky shtet, sipas kuadrit të brendshëm shqiptar, nuk është përfshirë në listën e vendeve të sigurta. Zhvillimet e ndodhura para dhe pas lejimit të ekstradimit të kërkuarit ngrenë dyshime serioze në drejtim të efektivitetit të garancive të dhëna nga autoritetet ruse.

62. Sipas Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë, duhet të kryhet një shqyrtim dy nivelesh për të përcaktuar nëse ekzistojnë “rrethana të jashtëzakonshme” që pengojnë dorëzimin e personit të shteti kërkuar; *i. hapi* i parë kërkon që gjykata që merret me kërkesën për dorëzim të shqyrtojë standardet e përgjithshme të paraburgimit në shtetin kërkuar, bazuar në të dhëna objektive, të besueshme, të sakta dhe të përditësuara siç duhet, në mënyrë që të vlerësojë nëse ka tregues specifikë të një rreziku real që të paraburgosurit në atë shtet trajtohen në mënyrë çnjerëzore ose degraduese. Tregues specifikë të kushteve të paraburgimit në mënyrë sistematike ose përgjithësisht të mangëta në shtetin kërkuar mund të merren, ndër të tjera, nga vendimet e gjykatave ndërkombëtare, të gjykatave të atij shteti ose të shteteve të tjera, si dhe nga vendimet, raportet dhe dokumentet e organeve të Këshillit të Evropës ose të Kombeve të Bashkuara e të tjera; *ii. hapi* i dytë kërkon që gjykata të shqyrtojë nëse rrethanat specifike të individit të prekur përbëjnë bazë të konsiderueshme për të besuar se, pas dorëzimit, ai do të ekspozohet ndaj një rreziku real të trajtimit çnjerëzor ose degradues për shkak të kushteve të paraburgimit në shtetin kërkuar, çka kërkon një shqyrtim të përditësuar dhe të detajuar të situatës ashtu siç ishte në kohën e dhënies së vendimit. Duke pasur parasysh se ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues është absolut, shqyrtimi i kushteve të paraburgimit nga gjykata nuk mund të kufizohet vetëm në mangësi të dukshme, por duhet të bazohet në një vlerësim të përgjithshëm të kushteve përkatëse të paraburgimit. Sipas asaj gjykate, nga neni 4 i Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian lind një detyrim për të shqyrtuar rastin individual dhe për të kërkuar informacione shtesë për të sqaruar nëse e drejta themelore e personit të prekur respektohet në rastin

e dorëzimit. Informacioni shtesë që gjykata duhet të kërkojë është parakusht për të siguruar një bazë të mjaftueshme faktike për vlerësimin nëse një individ përballet me rrezikun e trajtimit çnjerëzor ose degradues. Prandaj, gjykata që shqyrton kërkesën duhet të shtyjë vendimin derisa të marrë informacionin plotësues që i lejon asaj të përjashtojë ekzistencën e një rreziku të tillë dhe, nëse ky rrezik nuk mund të përjashtohet brenda një kohe të arsyeshme, gjykata duhet të vendosë nëse do ta ndërpresë procedurën e dorëzimit. Në këtë drejtim, një garanci e dhënë nga shteti kërkuar nuk e çliron gjykatën nga detyrimi për të bërë vlerësimin e saj të rrezikut me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së garancisë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, 2 BvR 1103/24, datë 24.1.2025*).

63. Gjykata vlerëson se, në rastet kur rezulton në mënyrë të qartë se një person i kërkuar për ekstradim ka arsye serioze për të besuar se në shtetin kërkuar mund t'i mohohet haptazi e drejta për gjykim të drejtë, pretendimi për cenimin e kësaj të drejte nuk mund të përjashtohet *a priori* nga vlerësimi i gjykatave të zakonshme. Në kuptim të dimensionit ekstraterritorial të standardeve të gjykimit të drejtë në procedurat e ekstradimit, edhe pse shteti i kërkuar nuk është i detyruar të verifikojë në mënyrë të plotë respektimin e procesit të rregullt ligjor në shtetin kërkuar për procedurat që i kanë paraprirë ekstradimit, ai nuk mund të anashkalojë prova që tregojnë ekzistencën e një rreziku real se, në rast se lejohet ekstradimi, personi mund t'i nënshtrohet një mohimi flagrant të drejtësisë, rrethanë kjo që përbën shkak të mjaftueshëm për të penguar ekstradimin në shtetin kërkuar. Një qëndrim i kundërt do të sillte një shqyrtim formalist të kërkesave për ekstradim, që injoron të drejtat themelore dhe nuk pajtohet me parimet e shtetit të së drejtës. Në këtë drejtim, neni 15, pika 2, i Kushtetutës parashikon se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

64. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se vendimet gjyqësore që kanë lejuar ekstradimin e kërkuarit nuk kanë përmbushur detyrimin për të sqaruar plotësisht rrethanat faktike që rezultonin nga aktet e paraqitura nga kërkuarja dhe as nuk kanë vlerësuar nëse ishte e nevojshme marrja e dokumentacionit kryesisht (*proprio motu*), sikundër nuk ka kanë kërkuar garanci shtesë lidhur me rrezikun e pretenduar për trajtimin e kërkuarit në



institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse, duke u mjaftuar me sigurinë e dhënë në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për ekstradim. Ndonëse në rastin konkret autoritetet kompetente dhe gjykatat kanë qenë në dijeni dhe kanë pasur informacion të mjaftueshëm për problemet sistemike në Federatën Ruse, bazuar në raportet e referuara nga kërkuuesi, por edhe lehtësisht të aksesueshme, që kanë të bëjnë me situatën e përkeqësuar dhe të rënduar në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në atë shtet, ato nuk kanë kryer një vlerësim të pavarur dhe të plotë. Në këtë kuptim, fakti që Federata Ruse, duke mos qenë më pjesë e Këshillit të Evropës dhe e KEDNJ-së, nuk mbart më të njëjtat detyrime konventore si shtetet e tjera anëtare, forcon nevojën për një vlerësim rigoroz të rrezikut ndaj të drejtave themelore të individit. Në këto kushte, garancitë e dhëna nga shteti kërkuar për garantimin e të drejtave themelore të kërkuarit nuk i çlironin autoritetet shqiptare nga detyrimi për të bërë një vlerësim të pavarur dhe të plotë të ekzistencës së rreziqeve aktuale në këtë drejtim.

65. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të zakonshme nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë, për sa kohë që, duke mos analizuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e kërkuarit për ekzistencën e kushteve që ndalojnë ekstradimin sipas nenit 491 të KPP-së, në thelb nuk i kanë garantuar atij të drejtën kushtetuese dhe konventore për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe për të pasur mbrojtje efektive në praktikë të të drejtave dhe lirive themelore.

B.2. Për mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese

66. Sipas kërkuarit, edhe pse institucionet janë informuar fillimisht për kërkesën për pezullim, ai është ekstraduar, procedurë që është bërë në fshehtësi, përpara se Gjykata të shprehej për pezullimin. Kërkuari ka pretenduar se, pas vendimit të pezullimit, pavarësisht se avokati i tij u përpoq të komunikonte me strukturat përgjegjëse për pezullimin e procedurës, ai nuk mori asnjë përgjigje. Sipas kërkuarit, prapësimi se njoftimi elektronik i Gjykatës i kryer pas orës 16:30 nuk është i vlefshëm, bie ndesh me nenin 57, shkronja “d”, të Kodit të Procedurave Administrative dhe se, në kuptim të detyrimit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës, institucionet publike janë të detyruara të organizojnë

punën për të garantuar zbatimin e menjëhershëm të tyre. Sipas tij, Ministria e Drejtësisë ia ka transferuar përgjegjësinë vetë Gjykatës, në cenim të parimit të ndarjes së pushteteve, duke e implikuar si burim të pasojave, të cilat, në fakt, burojnë nga mungesa e reagimit të saj si organ ekzekutues.

67. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se pas dorëzimit të kërkuarit te shteti kërkuar, shteti i kërkuar nuk ka më juridiksion në procesin e ekstradimit dhe ai konsiderohet i kryer. Sipas këtij subjekti, planifikimi i transportimit të kërkuarit, në zbatim të aktit të miratimit të ekstradimit, është kryer konform praktikës dhe procedurave të Interpolit dhe dispozitave konventore e ligjore, dhe nuk kushtëzohet nga asnjë akt i pritshëm gjyqësor. Sipas tij, kërkuari është transportuar në aeroport nga DPB-ja përpara se Gjykata të shprehej për pezullimin e procedurës, ndërkohë që legjislacioni nuk parashikon njoftimin e përfaqësuesit të personit të kërkuar për ekstradim, por Ministria e Drejtësisë komunikon me autoritetet qendrore dhe gjyqësore. Po sipas këtij subjekti, njoftimi zyrtar i vendimit të Gjykatës është bërë në rrugë elektronike në orën 17:54 dhe fizikisht në datën 31.10.2024, ndërkohë që njoftimi i kryer pas orarit zyrtar të ditës së punës nuk konsiderohet i kryer dhe prezumohet mosnjoftimi. Ministria e Drejtësisë ka qenë në kushtet e pamundësisë së kryerjes së veprimeve për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, për shkak të kohës së kufizuar në dispozicion që nga momenti i njoftimit elektronik të tij në orën 17:54. Për rrjedhojë, sipas subjektit të interesuar, moszbatimi i vendimit të Gjykatës nuk ka ardhur nga ndonjë veprim ose mosveprim i këtij institucioni, por si pasojë e pamundësisë efektive, pasi dorëzimi i kërkuarit, referuar procesverbalit të dorëzimit të Interpol Tiranë, është bërë në datën 30.10.2024, ora 16:45, kohë në të cilën Gjykata ende nuk kishte marrë vendimin.

68. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se pezullimi i ekstradimit sjell rrezikun që individit të largohet dhe të shmangë drejtësinë, duke dëmtuar procesin në Federatën Ruse, ndërsa ekstradimi në rastin konkret tregon angazhim për bashkëpunim në luftën kundër krimit, ndërkohë që në rastin konkret janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ekstradimin e kërkuarit.

69. KSHH-ja, në opinionin e saj këshillimor është shprehur se në vështrim të jurisprudencës së



Gjykatës, mozbatimi i vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për pezullimin e ekstradimit ka cenuar autoritetin e vetë Gjykatës ashtu edhe nenet 4, 124, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 132 të Kushtetutës dhe nenin 45 të Ligjit Organik të saj dhe se interesat e drejtësisë kushtetuese dhe shtetit të së drejtës e kapërcejnë interesin e kërkuarit, pasi veprimet e organeve shtetërore që kanë lejuar ekstradimin, përbëjnë shkelje të hapur të shtetit të së drejtës. Në vlerësimin e KSHH-së, mosekzekutimi i vendimit të pezullimit ka cenuar edhe procesin e mbrojtjes që shteti shqiptar duhet t’u ofrojë shtetasve të huaj që ekstradohen, kur ata pretendojnë se në vendet e origjinës (vendi kërkuar) do t’u nënshtrohen torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

70. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohej nga Kushtetuta, e cila, në nenet 132 dhe 145, sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015; nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

71. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur edhe me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të kësaj Gjykate (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 17, datë 10.4.2015; nr. 5, datë 7.2.2001, të Gjykatës Kushtetuese*), të cilat përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimet nr. 20, datë 5.4.2023; nr. 44, datë 29.6.2015; nr. 5, datë 7.2.2001, të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të njeriut, interpretimi përfundimtar i normës kushtetuese është në kompetencë të Gjykatës (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

72. Gjykata vëren se në datën 9.10.2024, pa pasur ende vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë, kërkuar, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i është drejtuar asaj me kërkesë për pezullimin e vendimit të datës 24.9.2024, të Gjykatës së Lartë, që kishte vendosur përfundimisht për lejimin e ekstradimit. Ndërkohë, pas përcjelljes nga Prokuroria e Përgjithshme të akteve në lidhje me procesin e ekstradimit të kërkuarit, përfshirë edhe një kopje të vendimit të shkurtuar të Gjykatës së Lartë (dispozitivin), ministri i Drejtësisë në datën 14.10.2024 ka miratuar, bazuar në parimin e specialitetit, sipas nenit 14 të Konventës për Ekstradimin dhe kuadrit ligjor në fuqi, ekstradimin e kërkuarit nga Shqipëria në Federatën Ruse dhe dorëzimin e tij nga Interpol Tirana brenda datës 30.10.2024.

73. Në datën 30.10.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin për shqyrtim të kërkesës për pezullim në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 30.10.2024, ora 17:15, referuar edhe informacioneve të marra nga institucionet kompetente për planifikimin e ekstradimit të kërkuarit në datën 30.10.2024, ora 18:20, bazuar në parashikimet e nenit 45, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, duke vlerësuar se ndodhej në kushtet e urgjencës, si dhe duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara nga kërkuarësi kanë të bëjnë me pretendime me natyrë kushtetuese, vendosi pranimin e kërkesës dhe pezullimin e përkohshëm të procedurave të ekstradimit të kërkuarit deri në një vendimmarrje të dytë të Gjykatës, kohë gjatë së cilës ai do të vijonte të qëndronte në kushtet e izolimit në pritje të ekstradimit.

74. Po në datën 30.10.2024, në bazë të urdhrit të drejtorit të DPB-së, kërkuarësi i është dorëzuar nga IEVP-ja “Mine Peza”, Tiranë, patrullës së shoqërimit të DPB-së dhe këta të fundit, sipas procesverbalit të dorëzimit, në orën 16:45 ia kanë dorëzuar kërkuarësin, në aeroportin e Rinasit, përfaqësuesve të Federatës Ruse, me qëllim ekstradimin e tij. Përfundimisht, përmes linjave ajrore, në orën 18:30 (ora lokale), kërkuarësi është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt Federatës Ruse, pavarësisht vendimit të Gjykatës që urdhëroi pezullimin e procedurës.

75. Gjykata thekson se vendimet e saj, pavarësisht nëse janë vendime të ndërmjetme, siç është edhe ai për pezullimin e ekstradimit, mbartin të njëjtën forcë detyruese për organet/palët të cilave



u kundërdrejtohen. Për rrjedhojë, moszbatimi i një vendimi të kësaj Gjykate mbart jo vetëm rrezikun e cenimit të të drejtave me natyrë individuale të kërkuesit në proces, por, më së pari dhe çka është më e rëndësishmja, prek vetë thelbin e funksionimit të shtetit të së drejtës, duke qenë se njëri prej pushteteve tejkalon pikërisht ato caqe që kushtetutëbërësi i konsideron si të padhunueshme dhe në mbrojtje të të cilave ka parashikuar një organ të posaçëm siç është Gjykata. Sipas GJEDNJ-së, masat e përkohshme, në përputhje me nenin 39 të KEDNJ-së, përdoren vetëm në raste të kufizuara dhe vetëm nëse ka rrezik të shkaktohen dëme të pariparueshme. Ato luajnë një rol thelbësor në shmangien e situatave të pakthyeshme, të cilat do ta pengonin atë gjykatë të shqyrtonte ankimin dhe, atje ku do të ishte e mundur, t'i siguronte ankuesit përfitimin praktik dhe efikas të të drejtave të Konventës që ai kërkonte. Në këto kushte, neni 34 i konventës do të shkelej nëse autoritetet e shtetit kontraktues nuk do të arrinin të ndërmerrnin të gjitha hapat që do të duhej të ishin ndërmarrë për të përmbushur masën e përkohshme. Sipas GJEDNJ-së, i takon Qeverisë të provojë nëse masa u plotësua ose, në një rast përjashtues, se pati një pengesë reale e cila ndaloi zbatimin e masës së përkohshme dhe se Qeveria mori të gjitha hapat e nevojshëm për ta hequr këtë pengesë dhe për ta mbajtur gjykatën të informuar rreth situatës (*shih Rrapo kundër Shqipërisë, datë 25.9.2012, §§ 81, 82*).

76. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i ngritur nga subjektet e interesuara është se dorëzimi i kërkuesit te përfaqësuesit e shtetit kërkues (Federata Ruse) është kryer përpara se Gjykata të merrte vendimin për pezullimin e ekstradimit, për rrjedhojë ato nuk kishin më juridiksion **efektiv**, në kuptimin e **mundësisë reale për të ndërmarrë veprime** që të parandalonin ose të ndërprisnin ekstradimin. Po ashtu, subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se njoftimi i vendimit të pezullimit është bërë nga Gjykata jashtë orarit zyrtar dhe, për këtë arsye, ka qenë e pamundur kryerja e veprimeve administrative që përfshijnë disa hallka në nivel hierarkik brenda institucionit. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata çmon të theksojë se kur ligji, në funksion të mbrojtjes së vlerave themelore dhe të drejtave kushtetuese, parashikon afate të shpejta, edhe në orë, për kryerjen e veprimeve, organet publike nuk mund të justifikojnë mosveprimin me orarin zyrtar, pasi ky arsyetim nuk përbën shkak të

pranueshëm për moszbatimin në kohë të detyrimeve. Përtej kësaj, në rastin konkret, Gjykata vëren se, pasi ajo u informua për faktin e planifikimit të ekstradimit të kërkuesit në pasditen e datës 30.10.2024, me shkresat nr. 942 dhe nr. 942/2, të po kësaj date, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe drejtorisë së Interpolit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me kërkesë për informacion për ekstradimin e kërkuesit, duke iu bërë të ditur edhe arsyen e kërkimit të informacionit. Shkresat përkatëse mbajnë shënimin “Tepër urgjent” dhe janë dërguar brenda orarit zyrtar dhe, në vijim, këto institucione i kanë dërguar Gjykatës informacionin e kërkuar. Po kështu, administrata gjyqësore e Gjykatës ka qenë në komunikim të vazhdueshëm, edhe telefonik, me personat përgjegjës në këto struktura, të cilët janë informuar edhe për faktin se, për shkak të urgjencës së çështjes, Gjykata kishte shqyrtuar kërkesën për pezullim. Pas marrjes së vendimit të pezullimit, ai u është komunikuar menjëherë, përmes telefonit, personave përgjegjës, ndërsa përmes postës elektronike, *e-mail*-i i orës 17:50, u është dërguar kopje e tij si Interpolit, ashtu edhe Ministrisë së Drejtësisë. Në aktet e paraqitura përpara Gjykatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit rezulton se, pasi është informuar për vendimin e Gjykatës, zyra e Interpol Tirana i është drejtuar Departamentit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Interpolit me *e-mail*-in e orës 17:56, me shënimin “Tepër urgjente”, duke kërkuar: “*konfirmimin për vijimin e ekstradimit ose ndërprerjen e tij*.” Po sipas këtij *e-mail*-i: “*Koha në dispozicion është shumë e limituar, pasi personi ndodhet në PKK Aeroporti Rinas dhe ka imbarkuar në avion. Jemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj*.”

77. Po kështu, sipas shkresës nr. 2923/a, datë 17.11.2025, të shoqërisë “Albcontrol” sh.a., në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata për verifikimin e pretendimit të përfaqësuesit të kërkuesit për kohën e gjatë që kërkuesi ka qëndruar në aeroport për shkak të vonesës së fluturimit, rezulton se, sipas informacionit të sektorit përkatës, për fluturimin e datës 30.10.2024 Tiranë-Stamboll: “*orari i nises ka qenë 17:20 UTC, ora lokale 18:20 dhe ka pasur vonesë prej 10 minutash, duke u nisur në orën 17:30 UTC, ora lokale 18:30*”.

78. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se, në momentin kur u kërkuar informacion për ekstradimin e kërkuesit dhe organet përgjegjëse u vunë në dijeni për kërkesën e tij për pezullimin e



ekstradimit, por edhe për shqyrtimin e saj me urgjencë nga Gjykata, kërkuesi nuk u ishte dorëzuar ende autoriteteve ruse. Më tej, që nga koha e marrjes së vendimit të pezullimit (ora 17:45) dhe komunikimit të tij (ora 17:50) deri në largimin e kërkuesit nga territori shqiptar (ora 18:30), nga organet përgjegjëse nuk rezulton të jetë ndërmarrë ndonjë veprim ose të jenë bërë përpjekje për marrjen e ndonjë mase me qëllim shtyrjen e ekstradimit në pritje të vendimit të Gjykatës dhe, më tej, shmangien e pengesës. Edhe pse këto institucione nuk kanë pasur pengesë të komunikojnë me Gjykatën, e cila ishte mbledhur për shqyrtimin e kërkesës për pezullim, ato as nuk kanë kërkuar informacion, as nuk kanë informuar Gjykatën, në vijimësi, për situatën faktike sipas zhvillimeve të saj të çastit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se detyrimi për një sjellje të tillë përbën zbatim praktik të parimit të luajalitetit kushtetues, i cili siguron, në thelb, respektin e ndërsjellë ndaj kompetencave të njëri-tjetrit dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi ndërmjet institucioneve. Parimi i bashkëpunimit luajal shpreh nevojën për një model qeverisjeje ku mekanizmat veprojnë në mënyrë eficiente, pasi një model i tillë, me detyrimin që cakton ndaj organeve, e bën Kushtetutën funksionale (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 41, datë 19.7.2012; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund të pranojë asnjë nga argumentet e subjekteve të interesuara për pamundësinë e të vepruarit në rastin konkret.

79. Sipas subjekteve të interesuara, kërkuesi u ishte dorëzuar autoriteteve ruse përpara marrjes së vendimit ose komunikimit të tij, për rrjedhojë autoritetet shqiptare nuk kishin më juridiksion mbi të. Gjykata ka theksuar se koncepti kushtetues i territorit përmban dy aspekte, aspektin fizik dhe aspektin juridiksional. Për sa i takon aspektin fizik, territori përfshin hapësirën tokësore dhe ujore të përfshira brenda kufijve (lumenj, liqene, dete të brendshme), nëntokën dhe thellësitë nënujore, si dhe hapësirën ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale e të brendshme detare. Ndërsa në aspektin juridiksional, territori përfshin hapësirën ku institucionet publike të rendit tonë kushtetues ushtrojnë juridiksionin e tyre dhe ku gjen zbatim sistemi normativ shqiptar. Këto dy aspekte të territorit përcaktojnë, ndër të tjera, edhe përgjegjësinë e shtetit për mbrojtjen e të drejtave dhe

lirive themelore të njeriut (*shih vendimin nr. 2, datë 20.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se Konventa për Ekstradimin, ndërsa parashikon rregullat, procedurat dhe kushtet për ekstradimin e personave, nuk përmban parashikime në lidhje me përjashtimin e juridiksionit të shtetit të kërkuar në momentin e dorëzimit të personit që ekstradohet dhe për sa kohë ai vijon të ndodhet ende në territorin e atij shteti. Gjykata, referuar *e-mail*-it të Interpol Tiranë drejtuar Departamentit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Interpolit, në të cilin ndodhet edhe shënimi për njoftimin e Ministrisë së Drejtësisë, vëren se ka ekzistuar në fakt mundësia për ndërprerjen/shtyrjen e ekstradimit. Po kështu, sipas nenit 18, pika 5, të Konventës për Ekstradimin, në rast force madhore që pengon dorëzimin ose pritjen e individit që ekstradohet, pala e interesuar informon palën tjetër dhe të dyja palët bien dakord për një datë tjetër të dorëzimit.

80. Në vlerësimin e Gjykatës, në këndvështrim kushtetues, nuk ka asnjë diskutim ose dyshim se në kohën që ajo ka dhënë vendimin për pezullimin e ekstradimit, kërkuesi ka qenë ende në territorin shqiptar, në kuptimin fizik dhe juridiksional të tij. Dorëzimi i tij tek autoritetet ruse nuk përbën, në vetvete, kalim të juridiksionit të shtetit shqiptar dhe as nuk i jep shtetit kërkues të drejtën të ushtrojë juridiksion *extraterritorial*. Në këto kushte, i takonte organit qendror përgjegjës në procedurën administrative të ekstradimit, Ministrisë së Drejtësisë, që të merrte çdo masë që ishte e nevojshme, në ushtrim të juridiksionit të shtetit shqiptar, për të penguar/shtyrë ekstradimin e kërkuesit. Referuar prapësimeve të subjekteve të interesuara, duket se mosekzekutimi ka ndodhur për çështje që lidhen me organizimin e brendshëm dhe, ndoshta edhe me rregulla të brendshme për reagimin në kohë ndaj çdo situatë që mund të lindë deri në momentin e largimit përfundimtar të personit të ekstraduar nga territori i Republikës së Shqipërisë, përfshirë edhe ekzekutimin e një vendimi të mundshëm të Gjykatës për pezullimin e ekstradimit. Në këtë kuptim, sjellja e autoriteteve në kundërshtim me parimin e luajalitetit kushtetues, që synon të garantojë ushtrimin pa pengesa të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga çdo organ i pushtetit shtetëror (*shih vendimet nr. 84, datë 23.12.2024; nr. 60, datë 16.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), në mungesë të një justifikimi objektiv, sikundër edhe mungesa e informimit të Gjykatës për



situatën, pavarësisht informimit dhe komunikimit që ajo pati me strukturat përgjegjëse në këto institucione, në aspektin institucional mbetet të kualifikohet si shkelje e detyrimit kushtetues për zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

81. Sipas nenit 39 të Kushtetutës, ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor (*pika 2*), ndërsa dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj (*pika 3*). Gjykata, bazuar në këtë dispozitë kushtetuese vlerëson se lejimi i ekstradimit të kërkuarit nga autoritetet shqiptare, edhe pse në kushtet e urdhërimit prej saj për pezullimin e çdo veprimi që do të passillte largimin e tij nga territori shqiptar, ka prodhuar, në thelb, efektet e largimit të detyruar të një shtetasi të huaj. Në kushtet që Gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimit të ekstradimit, konsiderohet se vijimi i qëndrimit të kërkuarit në shtetin shqiptar ishte i ligjshëm dhe ai gëzonte çdo të drejtë, garanci dhe mbrojtje kushtetuese, në kuptim edhe të nenit 39 të Kushtetutës.

82. Gjykata, e ndodhur në situatën aktuale, çmon se është e nevojshme të ndalet edhe në përmbajtjen e dispozitave të KPP-së, me qëllimin për të vlerësuar nëse sjellja e subjekteve të përfshira në procedurën e ekstradimit përcaktohet ose ndikohet edhe nga vetë përmbajtja e normave procedurale që rregullojnë procedurën e ekstradimit. Ekstradimi për jashtë shtetit rregullohet nga KPP-ja (nenet 488-503), ndërsa rregullat plotësuese parashikohen edhe në ligjin nr. 10193/2009 (nenet 31-47). Sipas nenit 499, pika 1, të KPP-së, Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin brenda 30 ditëve nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, ndërsa neni 462, pika 3, i kodit përcakton kur një vendim merr formë të prerë, ku në rastet e ekstradimit i tillë është vendimi i Gjykatës së Lartë nëse çështja shqyrtohet prej saj. Nga leximi i nenit 499, pika 1, të KPP-së, duket se afati ligjor brenda të cilit Ministria e Drejtësisë duhet të disponojë për ekstradimin fillon nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, pra nga data e vendimit gjyqësor përkatës. Megjithatë, KPP-ja nuk përcakton mënyrën sesi njoftohet Ministria e Drejtësisë për vendimin gjyqësor dhe nëse asaj i njoftohet vendimi i arsyetuar ose vetëm njoftimi për marrjen e vendimit. Ndërkohë, ligji nr. 10193/2009 parashikon rregulla

për njoftimin dhe për përcjelljen e akteve. Sipas tij, vendimi i gjykatës për ekstradimin depozitohet në sekretarinë gjyqësore brenda 3 ditëve nga shpallja (neni 39, pika 3) dhe Prokurori i Përgjithshëm i përcjell ministrit të Drejtësisë të gjitha aktet, brenda 7 ditëve nga data e marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor për ekstradimin (neni 40, pika 1). Kur vendimi gjyqësor është në favor të ekstradimit, ministri i Drejtësisë, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, mund të urdhërojë ekstradimin, duke respektuar afatin 30-ditor sipas nenit 499 të KPP-së (neni 40, pika 2).

83. Gjykata ka theksuar se, gjatë zbatimit të ligjit në ushtrim të funksionit të tyre, gjykatat shfaqen edhe si interpretueset e para të normës ligjore (*shih vendimin nr. 45, datë 11.6.2024*) dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i atyre gjykatave dhe, për më tepër, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, gjykatat e zakonshme, veçanërisht Gjykata e Lartë, duhet të interpretojnë parashikimet ligjore në përputhje me qëllimin dhe frymën e ligjvënësit, për të garantuar zhvillimin e një procesi të drejtë dhe respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese të individit. Ndërsa ka pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë, Gjykata ka theksuar se kur interpretimi dhe zbatimi i ligjit në një çështje konkrete cenon parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë edhe ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Gjykata vëren se, sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, dispozitat e mësipërme janë interpretuar në kuptimin që afati 30-ditor fillon nga data që vendimi ka marrë formë të prerë dhe se ai jo domosdoshmërisht duhet të jetë i arsyetuar, pasi, në funksion të disponimit politik (administrativ), sipas këtij subjekti, nuk është e rëndësishme njohja me arsyet se përse gjykatat kanë disponuar në favor të ekstradimit, dhe për Ministrinë e Drejtësinë i rëndësishëm është vetëm verifikimi se kontrolli gjyqësor ka përfunduar. Po sipas këtij subjekti, e drejta për ankim kushtetues është e garantuar dhe Gjykata mund të vendosë pezullimin e akteve të ekstradimit, masë që nuk mbështetet domosdoshmërisht në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Sipas subjektit të



interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, ky institucion i është referuar datës kur vendimi përfundimtar ka marrë formë të prerë dhe KPP-ja nuk lë vend për interpretim se, me mbarrimin e afatit 30-ditor, nëse nuk është disponuar nga ministri, personi për të cilin është kërkuar ekstradimi lirohet. Po sipas këtij subjekti, vendimi final i arsyetuar është baza për arsyetimin e disponimit të ministrit, por nëse ai vendim ka konfirmuar vendimet e mëparshme, konsiderohet se nuk është e nevojshme pasja e arsyetimit të tij, pasi ministri i referohet arsyetimit të gjykatave më të ulëta, ndërkohë që çdo subjekt i ekstradimit ka të drejtë të ushtrojë ankimin kushtetues individual.

85. Bazuar në qasjet e subjekteve të interesuara, Gjykata vëren se zbatimi në praktikë i dispozitave procedurale të sipërcituara nuk shfaqet i njëtrajtshëm, duke u kushtëzuar nga mënyra sesi Gjykata e Lartë ka disponuar në raport me gjykatat më të ulëta. Ndërkohë, referuar dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Lartë në rastin konkret, mes të tjerash, është urdhëruar që një kopje e vendimit t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë dhe të njoftohet Prokuroria e Përgjithshme dhe rekursuesi, çka presupozon komunikimin e vendimit të arsyetuar të kësaj gjykate. Megjithatë, faza administrative e procedurës së ekstradimit të kërkuarit ka vijuar, me qëllim respektimin e afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 499, pika 1, të KPP-së, edhe në kushtet kur vendimi përfundimtar ende nuk ishte arsyetuar. Si rrjedhojë, është krijuar një mospërputhje midis shpejtësisë së përmbylljes së procedurës së ekstradimit, për shkak të afatit të ngushtë ligjor, dhe kushteve procedurale që mundësojnë ushtrimin efektiv të ankimit kushtetues individual.

86. Duke marrë shkas nga një situatë e tillë, Gjykata çmon të evidentojë se në mungesë të vendimit të arsyetuar, individi i prekur nga ekstradimi vihet në pamundësi reale për të paraqitur ankim kushtetues individual, pasi ligji kërkon depozitimin e aktit të kundërshtuar (neni 27, pika 2, shkronja “e”, i Ligjit Organik të Gjykatës) dhe vetë formulimi i pretendimeve kushtetuese kushtëzohet nga njohja me arsyetimin e gjykatës së zakonshme. Po ashtu, edhe kur individi kërkon pezullimin e ekstradimit përpara paraqitjes së ankimit kushtetues (afati i të cilit është 4 muaj nga momenti i konstatimit të cenimit, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës), Gjykata vihet në vështirësi objektive në vlerësimin *prima facie* të

bazueshmërisë së kërkesës, për sa kohë nuk ka në dispozicion vendimin gjyqësor përfundimtar të arsyetuar. Pa këtë vendim, Gjykata e ka të vështirë të verifikojë nëse pretendimet e kërkuarit janë ngritur më parë përpara gjykatave të zakonshme (shërimi i mjeteve) dhe nëse ai ka marrë një përgjigje të arsyetuar mjaftueshëm. Kjo është e domosdoshme për të vlerësuar nëse vijimi i ekstradimit, përpara shqyrtimit në themel të çështjes, rrezikon të sjellë pasoja të pariparueshme dhe shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe për të shmangur përdorimin abuziv të këtij mjeti ligjor.

87. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se, për të garantuar të drejtën e ankimit kushtetues individual dhe efektivitetin e tij, dispozitat e KPP-së lidhur me fillimin e afatit 30-ditor brenda të cilit ministri i Drejtësisë duhet të disponojë për ekstradimin, nuk mund të lexohen në mënyrë të shkëputur dhe as të interpretohen literalisht. Ato duhet të interpretohen në mënyrë sistematike dhe teleologjike, në bashkërendim me dispozitat e ligjit nr. 10193/2009 për njoftimin dhe përcjelljen e akteve nga Prokurori i Përgjithshëm, si dhe në përputhje me parimin kushtetues të efektivitetit të mjeteve juridike. Në këtë kuptim, “momenti procedural vendimtar” për vënien në lëvizje të fazës administrative dhe llogaritjen reale të afatit nuk mund të reduktohet vetëm në datën e shpalljes së vendimit të formës së prerë, por duhet të mbajë në konsideratë edhe vënien në dispozicion, komunikimin, të vendimit gjyqësor të arsyetuar, si akt që bën të mundur, njëkohësisht, ushtrimin real të së drejtës së ankimit kushtetues dhe zhvillimin e rregullt të fazës administrative të procesit të ekstradimit. Një interpretim i ndryshëm do ta kthente ankimin kushtetues dhe kërkesën për pezullim në mjete **thjesht teorike**, duke krijuar një çekuilibër të pajustifikuar midis kërkesës për efikasitet në procedurën e ekstradimit dhe detyrimit për mbrojtje efektive të të drejtave kushtetuese. Për pasojë, një qasje e tillë kërkon që gjykatat e zakonshme të sigurojnë, brenda një kohe sa më të shpejtë, përgatitjen dhe komunikimin e vendimeve të arsyetuara, ndërsa autoritetet përgjegjëse për fazën administrative të organizojnë dhe të ndërmarrin veprimet procedurale në mënyrë që ushtrimi i ankimit kushtetues dhe kërkesa për pezullimin e ekstradimit të mos bëhen të pamundura në praktikë.

88. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit në drejtëm të së drejtës për të



mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues, të parashikuar në nenin 25 të Kushtetutës, të lidhur me standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si dhe ato në drejtim të së drejtës për të mos u dëbuar, të parashikuar në nenin 39 të Kushtetutës, të lidhur me detyrimin e autoriteteve publike për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës, janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht. Gjykata arrin në këtë përfundim, pasi shfuqizimi i vendimeve gjyqësore dhe dërgimi i çështjes për rigjykim nuk mund të prodhojë më një rezultat praktik, duke pasur parasysh se kërkuesi është ekstraduar tashmë. Për këtë arsye, ajo duhet të konstatojë cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkuesit, konstatim që, në vlerësimin e saj, përmbush kërkesën e efektivitetit të mjeteve juridike.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuesit për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues, të parashikuar në nenin 25 të Kushtetutës të lidhur me standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuesit për të mos u dëbuar, të parashikuar në nenin 39 të Kushtetutës të lidhur me detyrimin e autoriteteve publike për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

4. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 14.1.2026.

Shpallur më 23.2.2026.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Marjana Semini

Anëtare kundër: Sonila Bejtja

Anëtar pjesërisht kundër: Sandër Beci

MENDIM KUNDËR PJESËRISHT DHE PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Igor Kokunov, shumica ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, pasi ka gjetur shkelje të së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues, të parashikuar në nenin 25 të Kushtetutës, të lidhur me standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, dhe të së drejtës për të mos u dëbuar, të parashikuar në nenin 39 të Kushtetutës, të lidhur me detyrimin e autoriteteve publike për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës.

2. Unë, gjyqtarja Sonila Bejtja, kam votuar tërësisht kundër këtij qëndrimi të shumicës bazuar në qasjen se kërkesa është e pabazuar, ndaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i saj, ndërsa unë, gjyqtari Sandër Beci, kam votuar pjesërisht kundër, vetëm për sa i përket bazueshmërisë së *pretendimit për mos ekzekutimin e vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për pezullimin e ekstradimit të kërkuesit*. Për rrjedhojë, për sa kohë që në lidhje me këtë pretendim të fundit qëndrimet tona si gjyqtarë në pakicë bashkohen, do të parashatrojmë në vijim argumentet mbi të cilat mbështesim këtë qasje të përbashkët.

3. Fillimisht, ne i bashkohemi shumicës në lidhje me sa ka parashtruar për detyrimin kushtetues për zbatimin e vendimeve të Gjykatës, pavarësisht nëse ato janë vendime përfundimtare ose të ndërmjetme, për sa kohë mbartin të njëjtën forcë detyruese për organet/palët të cilave u kundërdrejtohen. Megjithatë, në vlerësimin tonë, në rastin konkret ekzekutimi i vendimit që ka lejuar ekstradimin e kërkuesit, pavarësisht vendimit të pezullimit të Gjykatës, nuk ka passjellë shkelje kushtetuese. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje ka rezultuar, pa asnjë ekuivok, se vendimi i pezullimit është njoftuar dhe më pas është komunikuar zyrtarisht shumë më vonë se momenti kohor në të cilin autoritetet përgjegjëse kanë dorëzuar kërkuesin në zbatim të urdhrit të ministrit të Drejtësisë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që kishte lejuar ekstradimin, në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar sipas Konventës për Ekstradimin. Pa dashur të biem në përsëritje në lidhje me faktet e çështjes, të cilat janë detajuar në mënyrë të plotë në vendim, Ministria e Drejtësisë dhe çdo organ tjetër përgjegjës përgjatë gjithë procedurës së ekstradimit të kërkuesit kanë vepruar në *bona fide* dhe në përputhje me parimin e ligjshmërisë e atë të



luajalitetit kushtetues, duke zbatuar rigorozisht parashikimet e dispozitave procedurale penale dhe të akteve ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar është palë.

4. Edhe pse në datën 30.10.2024, me qëllim shqyrtimin e kërkesës për pezullim, Gjykata ka kërkuar informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhej ekstradimi i kërkuarit, ajo nuk ka njoftuar paraprakisht organet kompetente për kohën e shqyrtimit të kërkesës për pezullim dhe as nuk ka kërkuar marrjen e ndonjë mase të veçantë në këtë drejtim, në situatën që për shkak të kohës së rënë dakord nga palët për ekstradimin e kërkuarit organet e përfshira në këtë procedurë do të duhej të merrnin masat përkatëse administrative që nga shoqërimi i kërkuarit, transportimi drejt aeroportit të Rinasit dhe dorëzimi i tij autoriteteve të shtetit kërkuar. Pra, fakti që Gjykata, pasi u informua për planifikimin e ekstradimit të kërkuarit në pasditen e datës 30.10.2024, iu drejtua Ministrisë së Drejtësisë dhe drejtorisë së Interpolit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me kërkesë për informacion, duke u bërë të ditur edhe arsyen e kërkimit të informacionit, as nuk mund të konsiderohet si shkak për të vënë ato organe në diskutim vijimin e procedurës së ekstradimit, e cila sipas Konventës për Ekstradimin i ishte njoftuar edhe palës tjetër, as nuk mund të konsiderohet si njoftim për pezullimin e çdo veprimi/procedure deri në pritje të vendimit të Gjykatës. Edhe pse administrata e Gjykatës ka qenë në komunikim me administratën e këtyre institucioneve, deri në momentin e njoftimit zyrtarisht të vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve për pezullimin, organi përgjegjës, Ministria e Drejtësisë dhe asnjë institucion tjetër i përfshirë nuk kanë pasur asnjë shkak ligjor mbi të cilin të vinin në dyshim vijimin e procedurës së ekstradimit.

5. Ndërsa planifikimi i dorëzimit të kërkuarit, në zbatim të vendimit të formës së prerë për lejimin e ekstradimit, është bërë nga ministri i Drejtësisë sipas afateve të KPP-së dhe data e koha e dorëzimit i është njoftuar palës tjetër, procedura administrative për zbatimin e këtij akti nuk mund të kushtëzohet ose ndërpritej për shkak të një vendimi të pritshëm të Gjykatës. Për rrjedhojë, moszbatimi i vendimit të Gjykatës nuk ka ardhur nga ndonjë veprim ose mosveprim i institucioneve të përfshira në procedurën e ekstradimit, por si pasojë e pamundësisë efektive, pasi dorëzimi i kërkuarit,

referuar procesverbalit të dorëzimit të Interpol Tiranë, është bërë në datën 30.10.2024, ora 16:45, pra më parë në kohë se Gjykata të vendoste pezullimin e ekstradimit. Në vlerësimin tonë, siç theksuam edhe më sipër, organet e përfshira në procedurën e ekstradimit kanë vepruar në përputhje me parimin e luajalitetit kushtetues, për sa kohë që në përputhje me kompetencat e tyre dhe në respektim të kompetencave të Gjykatës kanë vënë në dispozicion çdo akt dhe informacion të kërkuar dhe as nuk janë bërë pengesë, as nuk kanë shkaktuar me sjelljen e tyre vonesa për marrjen në shqyrtim të kërkesës për pezullim.

6. Në kuptim të sa më sipër, nuk mund tëi ngarkohet sjelljes së autoriteteve mungesa e eficientës në veprimin e mekanizmave, për sa kohë që mosekzekutimi i vendimit për pezullimin e ekstradimit ka ardhur si pasojë e pamundësisë së tyre për të vepruar në rastin konkret, e provuar kjo edhe nga parashtrimet dhe aktet e paraqitura nga palët në procesin kushtetues. Në këtë aspekt vlerësojmë të theksojmë, gjithashtu, se për sa i përket analizës së dispozitave ligjore të KPP-së në drejtim të afatit 30-ditor për ekstradimin dhe momentit nga i cili fillon të ecë ai, edhe pse i bashkohemi qasjes së shumicës për mënyrën sesi duhet të zbatohen këto dispozita nga organet administrative me qëllim garantimin e efektivitetit të ankimit kushtetues individual, ne jemi të qasjes se në rastin e kërkuarit edhe Gjykata duhej të ishte treguar më e kujdesshme gjatë procedurës administrative të verifikimit të elementeve formale të ankimit kushtetues individual, duke pasur parasysh natyrën e çështjes dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara.

7. Për sa i përket Konventës për Ekstradimin, siç ka parashtruar edhe subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, pas momentit të dorëzimit të personit autoriteteve të shtetit kërkuar, pavarësisht se ai ndodhet ende në territorin e shtetit të kërkuar, ky i fundit nuk ka më juridiksion mbi atë person. Konventa për Ekstradimin, e cila parashikon rregullat, procedurat dhe kushtet për ekstradimin e personave, ka përcaktuar mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të personit që ekstradohet, por nuk përmban parashikime për juridiksionin e shtetit të kërkuar deri në momentin e largimit të tij nga territori. Në procedurën e ekstradimit, në kuptim të së drejtës ndërkombëtare, shteti i kërkuar vepron për llogari të shtetit kërkuar, për sa kohë që ndalimi i personave që kërkohet të ekstradohen deri në



dorëzimin e tyre bëhet mbi bazën e vendimeve të shtetit kërkues, i cili në këtë mënyrë ushtron juridiksion ekstraterritorial për mbrojtjen e interesave të tij ose të shtetasve të tij, të cilat janë cenuar nga sjellja/veprimet e individit që kërkohet të ekstradohet. Çështja e juridiksionit të shtetit kërkues është, për këtë arsye, edhe një nga elementet që verifikohen si për paraqitjen e kërkesës për ekstradim, ashtu edhe për lejimin e ekstradimit. Kjo do të thotë se shteti i kërkuar nuk mund të mohojë kërkesën për ekstradim mbi konsiderata që lidhen me ushtrimin ose përjashtimin e juridiksionit të shtetit kërkues, por vetëm në ato raste që parashikohen shprehimisht në Konventën për Ekstradimin. Në këtë kuptim, në momentin e dorëzimit efektiv autoriteteve të personit që mbahet në shtetin e kërkuar për llogari të shtetit kërkues, ky i fundit merr juridiksion *in personam* mbi individin që ekstradohet. Mbi këtë qasje, ne vlerësojmë se autoritetet shqiptare përgjegjëse në procedurën e ekstradimit kanë vepruar në përputhje me kompetencat e tyre dhe në ushtrim të detyrimeve ndërkombëtare dhe se veprimet e tyre nuk kanë qenë shkaktare për mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës për pezullimin e ekstradimit të kërkuesit.

8. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit për cenimin e së drejtës së jetës dhe asaj për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor, unë, gjyqtarja Sonila Bejtja, kam mbajtur qasjen se edhe ky pretendim është i pabazuar, ndaj ai duhej të ishte rrëzuar.

9. Kërkuesi e ka bazuar qëndrimin e tij në të dhënat që rezultojnë nga raporte të organizatave, si: *Amnesty International, Transparency International, Human Rights Watch, Freedom House* etj., që referojnë për torturën dhe keqtrajtimet e të burgosurve në institucionet penitenciare në Federatën Ruse, si dhe shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, ashtu edhe në gjendjen e tij shëndetësore, çka është pretenduar se vështirësonte qëndrimin e tij në institucionet e vuajtjes së dënimit në Rusi.

10. Në lidhje me këtë pretendim shumica ka vlerësuar se, në kuptim të barrës së provës, në parim i takon kërkuesit të paraqesë prova për të vërtetuar se ka arsye të konsiderueshme për të besuar se, nëse masa do të zbatohet, ai do të ekspozohet ndaj një rreziku real për t'iu nënshtruar trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të konventës dhe nëse të tilla prova janë paraqitur, i takon qeverisë të largojë çdo dyshim në këtë drejtim (*shih paragrafin 54 të vendimit*). Për sa i përket pretendimit për gjendjen

shëndetësore të kërkuesit, si një nga shkaqet mbi të cilat është mbështetur pretendimi për moslejimin e ekstradimit, i bashkohem shumicës në qëndrimin se pavarësisht akteve dhe dokumenteve të paraqitura si në gjykimin e zakonshëm, ashtu dhe atë kushtetues, ato nuk sjellin të dhëna për të arritur në përfundimin se situata shëndetësore e kërkuesit është e tillë që mund të vinte në diskutim ekzistencën e rreziqeve dhe pasojave për jetën e tij, në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së, pra nuk janë të tilla që të zhvendosin barrën e provës tek autoritetet (*shih paragrafin 56 të vendimit*). Por, unë ndahem nga shumica për sa i përket shkakut tjetër të pretenduar nga kërkuesi, konkretisht atij për gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut në shtetin kërkues, pasi vlerësoj se, mbi të njëjtën qasje për zhvendosjen e barrës së provës, kërkuesi nuk ka arritur të paraqesë prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tij.

11. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, referuar dispozitave të Konventës për Ekstradimin, rezulton se është shteti kërkues që paraqet kërkesën për ekstradim të shoqëruar me dokumentet mbështetëse dhe në rast se informacioni i kërkuar është i pamjaftueshëm për të lejuar marrjen e vendimit nga shteti i kërkuar, ky i fundit kërkon informacionet e nevojshme plotësuese në këtë drejtim (neni 13).

12. Në rastin e kërkuesit Ministria e Drejtësisë, si organi përgjegjës, pasi ka marrë kërkesën për ekstradim dhe ka verifikuar respektimin e kriterëve formale, ia ka përcjellë atë organit të prokurorisë, në shkallë hierarkie, e cila i është drejtuar në vijim gjykatës me kërkesë për lejimin e ekstradimit të kërkuesit. Gjykatat e zakonshme, në shqyrtimin e kësaj kërkeje, përveç ekzistencës së kriterëve që lejojnë ekstradimin, kanë marrë në shqyrtim edhe pretendimet e kërkuesit për sa i përket situatës në institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse dhe nivelin e respektimit nga ato autoritete të të drejtave të njeriut, duke i gjetur këto pretendime të pabazuara, sipas argumenteve të parashtruara në vendimet e tyre. Kështu, sipas gjykatës së apelit, pretendimet e kërkuesit nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete dhe, për më tepër, referuar kërkesës për ekstradim të datës 18.9.2023, autoritetet ruse kanë dhënë garancitë e nevojshme në kuptim të Konventës për Ekstradimin, duke siguruar që kërkesa për ekstradim nuk ka për qëllim përndjekjen e këtij personi për arsye politike, për shkak të racës,



fesë, kombësisë ose pikëpamjeve politike, dhe se do t'i ofrohen të gjitha mundësitë për mbrojtje, duke përfshirë ndihmën e avokatëve, se nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues dhe se do të ndiqet penalisht vetëm për krimin për të cilin kërkohet ekstradimi. Po kështu, vijon gjykata e apelit, sipas garancive të autoriteteve ruse, pas përfundimit të gjykimit dhe, në rast të një vendimi fajësie, pas vuajtjes së dënimit ose lirimit prej tij, kërkuesi do të mund të largohet nga territori rus. Gjithashtu, sipas gjykatës së apelit, Federata Ruse ka garantuar se në rast ekstradimi kërkuesi do të mbahet në një institucion që merr parasysh standardet e përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të datës 16 dhjetor 1966, duke dhënë edhe garancinë se punonjësit e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë do të mund ta vizitojnë atë për të monitoruar respektimin e këtyre garancive. Gjykata e apelit ka arsyetuar edhe se kërkuesi ka qenë disa herë i dënuar dhe në masa sigurimi në Federatën Ruse dhe në asnjë rast nuk ekziston një precedent i tillë i pretenduar për trajtimin e tij.

13. Ky pretendim i kërkuesit është marrë në shqyrtim edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili, në të njëjtën linjë me gjykatën e apelit, ka vlerësuar se shteti rus ka dhënë garanci se: kërkuesi nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues; se do të ndiqet penalisht vetëm për krimin për të cilin kërkohet ekstradimi; pas përfundimit të gjykimit dhe në rast të një vendimi fajësie pas vuajtjes së dënimit ose lirimit, kërkuesi do të mund të largohet nga territori rus; ai do të mbahet në një institucion që merr parasysh standardet e përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të datës 16 dhjetor 1966. Sipas atij kolegji, i pyetur nga gjykata e apelit për arsyet e largimit nga shteti rus ku ishte nën masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, kërkuesi nuk e ka lidhur këtë me frikën se kishte arsye të mendonte se do t'u nënshtrohej persekutimeve ose diskriminimeve, por me faktin se kishte nevojë për mjekimin e duhur të problemeve shëndetësore, duke pretenduar se nuk mund të merrte një mjekim të tillë në shtetin e tij. Për rrjedhojë, në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit për rrezikun e trajtimit të tij në burgjet ruse në rast ekstradimi është vlerësuar gjerësisht dhe në mënyrë të hollësishme nga gjykatat e zakonshme, duke

marrë ai përgjigje të arsyetuar se përse shkaqet e pretenduara se ndalonin ekstradimin ishin të pabazuara.

14. Në lidhje me këtë pretendim vlerësoj të theksoj edhe se kërkuesi Igor Kokunov është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol NCB Moska mbi bazën e vendimit penal të datës 18.2.2022, të Gjykatës Rajonale Moskë, Federata Ruse, me të cilin ndaj tij është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, për kryerjen e veprës penale “Marrja e një pozicioni më të lartë në hierarkinë penale”, të parashikuar nga neni 210.1 i KPR-së, veprë penale që lidhet me një veprimtari të paligjshme kriminale që dyshohet se ka kryer. Bazuar në materialet e çështjes konkrete në shqyrtim dhe vetë pretendimet e kërkuesit nuk rezultojnë që të ketë ndonjë dyshim për karakterin politik ose ushtarak të procedimit penal të nisur ndaj kërkuesit, çka përjashton çdo pretendim për mundësinë e përndjekjes së tij në Federatën Ruse për shkaqe ose arsye politike, që, në vlerësimin tim, do të ishte i aftë të vinte në dyshim edhe procedurën e ekstradimit dhe vendimet gjyqësore që e kanë lejuar atë në drejtim të mënyrës sesi janë vlerësuar garancitë që ka dhënë shteti kërkues. Për rrjedhojë, në mungesë të një pretendimi të tillë pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual lidhen thjesht me prezumimin, mbi konsiderata të përgjithshme, se ai do t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose degradues vetëm për shkak të gjendjes së kushteve të paraburgimit në shtetin rus, si dhe gjendjes së mbrojtjes të të drejtave të njeriut në atë shtet.

15. Edhe sipas GJEDNJ-së, ekzistenca e rrezikut të pretenduar duhet të vlerësohet kryesisht duke iu referuar atyre fakteve që ishin të njohura ose duhej të ishin të njohura në kohën e ekstradimit dhe se referenca ndaj një problemi të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend të caktuar nuk mund të shërbejë, në vetvete, si bazë për refuzimin e ekstradimit të një personi të caktuar. GJEDNJ-ja ka përcaktuar disa kritere që duhen përdorur në vlerësimin e cilësisë së garancive të dhëna, në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes në fjalë, duke përfshirë, ndër të tjera: i. kush ka dhënë garancitë dhe nëse ai person/autoritet ka fuqinë për të detyruar qeverinë e shtetit pritës; ii. nëse ato janë të formuluar në terma të përgjithshëm ose specifikë, dhe nëse janë dhënë nga një shtet palë; iii. nëse pajtueshmëria e shtetit kërkues me këto garanci



mund të kontrollohet në mënyrë objektive përmes mekanizmave diplomatikë ose të tjerë monitorues, për shembull, duke i siguruar kërkuesit akses të pakufizuar tek avokati; iv. nëse ekziston një sistem efektiv mbrojtjeje kundër torturës në shtetin pritës, duke përfshirë nëse është i gatshëm të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit (*shih paragrafin 55 të vendimit*). Edhe nëse i referohemi këtyre kriterëve, në rastin konkret rezulton se garancitë për ekstradimin e kërkuesit janë dhënë nga autoriteti kompetent, e verifikuar kjo gjatë gjykimit dhe e pranuar edhe nga Gjykata. Këto garanci nuk rezulton të jenë formuluar në terma të përgjithshëm, përkundrazi në mënyrë specifike duke garantuar autoritetet ruse, siç kanë argumentuar edhe gjykatat e zakonshme, se ekstradimi nuk është kërkuar për përndjekjen e kërkuesit për ndonjë nga arsyet që ndalojnë ekstradimin por për ekzekutimin e masës kufizuese të lirisë të dhënë ndaj tij dhe me qëllim gjykimin për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe se atij do t'i garantohet e drejta për proces të rregullt, se nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor. Ndërkohë që, siç ka parashtruar edhe subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë në kohën e lejimit të ekstradimit Federata Ruse ka qenë palë e Konventës së Këshillit të Evropës kundër Torturës.

16. Për sa u përket të dhënave të organizatave të të drejtave të njeriut, edhe pse ato janë marrë në konsideratë nga gjykatat, në vlerësimin tim, për sa kohë që janë të dhëna që vijnë nga burime jashtëgjyqësore ato nuk mund t'i mbivendosen ose të zhbëjnë/vënë në diskutim garancitë e përcjella përmes kanaleve diplomatike nga autoritetet kompetente të shtetit kërkues. Nga ana tjetër, për sa i përket faktit se Federata Ruse nuk është më pjesë e Këshillit të Evropës, ky fakt nuk vë në diskutim marrëdhëniet mes palëve anëtare të Konventës për Ekstradimin, por kanë të bëjnë thelbësisht me marrëdhëniet e Federatës Ruse kundrejt Këshillit të Evropës në drejtim të të drejtave dhe detyrimeve që lindin për këtë shkak. Në këto kushte nuk u takonte gjykatave të zakonshme të vinin në diskutim ose në dyshim respektimin e të drejtave të kërkuesit në shtetin kërkues vetëm mbi këtë fakt dhe vetëm mbi të dhëna që vinin nga burime jashtëgjyqësore. Në mungesë të provave për të adresuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet ndaj të cilave është pretenduar se mund të ekspozohet kërkuesi në Federatën Ruse, vendimet gjyqësore, në kuptim të rrethanave

specifike të rastit konkret, u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të tij të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Në ndryshim nga shumica, unë jam e qëndrimit se garancitë e dhëna nga shteti kërkues, Federata Ruse, për garantimin e të drejtave themelore të kërkuesit përbënin garanci të mjaftueshme për gjykatat shqiptare, në kuptim të Konventës për Ekstradimin, për të bërë një vlerësim të pavarur dhe të plotë të pretendimeve për ekzistencën e rreziqeve aktuale në këtë drejtim.

17. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, gjykatat e zakonshme, në kuptim të rrethanave specifike të rastit konkret, u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të ngritura përpara tyre nga kërkuesi, përfshirë ato për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtrohet trajtimit çnjerëzor dhe degradues, duke arsyetuar, në këtë mënyrë, edhe për mosekzistencën e kushteve që ndalonin ekstradimin e kërkuesit. Në këndvështrim të standardeve kushtetuese arsyetimi i vendimeve të kundërshtuara nuk duket të jetë arbitrar ose i pamjaftueshëm, pra që të vërë në dyshim vetë të drejtën për një gjykim të drejtë ose respektimin e të drejtave themelore të kërkuesit.

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja

URDHËR

Nr. 18, datë 22.1.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit në Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm, z Eugen Papandile.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.



4. Ky urdhër hyn në fuqi në datën 21.1.2026 dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Fiona Papajorgji

KËRKESË
Nr. 149/4, datë 23.2.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për një ndryshim në VKM-në nr. 608, datë 23.10.2025, ‘Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugëve ‘Kujtim Laro’ dhe ‘Kongresi i Manastirit’””.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni se pasuria nr. 3/74, ZK 8140, me nr. rendor 6, në emër të bashkëpronarëve Ali Kullakshi, Bukuriye Maliq Llabani, Hamide Mema, Muhamet Kullakshi, Naime Allamuça, Qefsere Kullakshi hiqet nga lista e shpronësimit të VKM-së nr. 608, datë 23.10.2025, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugëve ‘Kujtim Laro’ dhe ‘Kongresi i Manastirit’””, me efekt financiar zbritës 544,528.53 lekë, ku vlera totale nga 6,055,283.97 lekë bëhet 5,510,755.44 (pesë milionë e pesëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë pikë dyzet e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë

